



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 6.2.2026, e cila filloi në orën 10:15.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (Lidhja për Prishtinën), kryesues i Kuvendit, Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Lindita Rexhepi Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida Bujari (LVV), Berita Abazi Muhadri (LVV), Egzon Azemi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumnije Mikullovc (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Yll Bogaj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO).

Munguan: Sokol Havolli (LDK), Dhurata Jahaj Retkoceri (LDK), Besianë Musmurati (PDK), Leonora Shabani Bajraktari (LVV), Besa Shahini (PSD).

Të pranishëm ishin edhe: Florian Dushi - nënkryetar i komunës, Shkëmb Manaj - nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Arben Kqira - Ud drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësis, Samir Shahini - drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Liridon Shahini - Ud. drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Gëzim Kastrati - drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Donika Çetta - drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Fexhri Hyseni - Ud. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Luftar Braha - Ud. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelinë Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Kushtrim Mushica - drejtor i Drejtorisë së Sportit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të mediave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina - kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Propozim-vendim për miratimin e buxhetit të Kryeqytetit për vitin 2026.

Gëzim Sveçla: - tha se duke qenë se po shqyrtojmë buxhetin, dokumentin më të rëndësishëm që përcakton zhvillimin e qytetit dhe që përfshin 360 projekte, propozoj shmangien nga Rregullorja e Punës, në mënyrë që secili anëtar i Kuvendit të ketë mundësi të flasë pa kufizim kohe dhe të trajtojë në mënyrë të plotë këtë çështje kaq të rëndësishme.

Valbona Makolli: - tha se po paraqes para jush Propozim-buxhetin e Kryeqytetit për vitin fiskal 2026, të hartuar mbi parimet e transparencës, përgjegjësisë fiskale dhe të orientuar në nevojat reale të qytetarëve. Buxheti është përgatitur në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, strategjinë zhvillimore komunale dhe Qarkoren buxhetore të Ministrisë së Financave. Struktura buxhetore përfshin: 48.3 milionë euro për paga dhe mëditje, 32 milionë për mallra dhe shërbime, 3.5 milionë për shpenzime komunale, 6.8 milionë për subvencione dhe transfere, si dhe 60.8 milionë euro për investime kapitale. Ajo deklaroi se ky buxhet mbështet projektet transformuese të Kryeqytetit, përfshirë vazhdimin dhe përfundimin e projekteve madhore si rruga “George Bush”, nënkalmi “Agim Ramadani”, unaza e brendshme, ishulli urban dhe projekte të rëndësishme infrastrukturore e arsimore. Ajo gjithashtu garanton funksionimin e shërbimeve jetike për qytetarët, përfshirë transportin publik, pastrimin, ndriçimin dhe mbështetjen për ndërmarrjet publike, prandaj kërkoi nga ju që të votohet ky propozim- vendim për miratimin e buxhetit.

Jeta Rafuna Hasani: - deklaroi se grupi i asamblistëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah buxhetin e Kryeqytetit për vitin 2026, sepse ai adreson nevojat bazike të qytetarëve dhe siguron funksionimin normal të shërbimeve komunale, duke pasur një fokus të veçantë në investimet kapitale dhe projekte transformuese. Ajo tha se ky buxhet përfshin projekte të rëndësishme infrastrukturore dhe zhvillimore si: ishulli urban, “Rruga A”, Sheshi “George Bush”, investime në rrugë lokale, trotuare, ndriçim publik, kanalizim, si dhe ndërtimin e shkollave dhe çerdheve të reja. Po ashtu, mbështet mobilitetin urban, hapësirat e gjelbra, shëndetësinë dhe përmirësimin e shërbimeve komunale. Ajo tha se e përkrahim këtë buxhet duke kërkuar zbatim transparent dhe efikas, sepse e konsiderojmë atë investim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe të ardhmen e Prishtinës.

Leutrim Retkoceri: - tha se buxheti i vitit 2026 është një vendim kyç për stabilitetin dhe të ardhmen e Prishtinës. Grupi i asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës shpreh përkushtimin për të kontribuar në miratimin e tij, duke kërkuar transparencë, përfshirjen e qytetarëve, dëgjime publike dhe planifikim të përgjegjshëm. Përtej dallimeve politike, prioritet mbetet stabiliteti institucional dhe interesi i qytetarëve të kryeqytetit.

Gëzim Sveçla: - deklaroi se ky buxhet po sillet në seancë të jashtëzakonshme dhe pa praninë e kryetarit, çka tregon mungesë serioziteti dhe përgjegjësie politike. Rritja prej 18 % nuk është rezultat i performancës së komunës, por i rritjes së buxhetit nga niveli qendror, ndërsa të hyrat vetanake rriten vetëm 7 %, duke dëshmuar stagnim ekonomik lokal dhe po kërkohet të votohet një

buxhet prej 150 milionë eurosh pa raport financiar paraprak dhe pa u diskutuar gjetjet e auditorit. Sveçla tha se projektet madhore si Sheshi “George Bush”, lidhja e Arbërisë dhe tuneli në rrugën “Agim Ramadani” shoqërohen me probleme ligjore dhe paqartësi. Ai deklaroi se Unaza e Prishtinës nuk figuron fare në buxhet, ndonëse paraqitet publikisht si prioritet. Drafti aktual ndryshon nga ai i nëntorit si rezultat i pazareve politike, jo planifikimit strategjik. Sveçla u shpreh se ky buxhet nuk garanton zhvillim urban, nuk përmirëson shërbimet publike dhe nuk rrit cilësinë e jetës së qytetarëve. Për këto arsye Lëvizja Vetëvendosje nuk e voton këtë buxhet.

Arbenita Murseli: - tha se grupi ynë mbështet miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2026, sepse besojmë se përmes një planifikimi të drejtë sigurohet mirëqenia dhe zhvillimi i qytetarëve. Ne kemi kërkuar fokus të veçantë për zonat rurale, duke theksuar se nevojat e fshatrave janë po aq të rëndësishme sa ato të zonave urbane. Ajo deklaroi se nuk jemi për bllokim të proceseve, por për avancim dhe realizim të projekteve në të mirë të të gjithë qytetarëve, për këtë arsye, e votojmë buxhetin.

Endrit Zabërgja: - deklaroi se në fillim të këtij mandati, kemi mundësinë t’i japim kryeqytetit një start të fuqishëm, me prioritet të qartë për të mirën e qytetarit, kurse përvoja e viteve të kaluara na ka treguar se bllokadat dhe inatet politike nuk i shërbejnë askujt, përveçse e dëmtojnë qytetarin. Zabërgja tha edhe pse mund të mos pajtohemi 100 % me çdo pikë të buxhetit, ai përfaqëson një kornizë të nevojshme për realizimin e projekteve dhe zhvillimin e kryeqytetit. Ai tha se roli ynë është ta mbështesim procedimin e tij dhe njëkohësisht ta mbikëqyrim zbatimin me përgjegjësi të plotë. Për këtë arsye, Nisma Socila Demokrate e mbështet këtë buxhet, me shpresë që të gjitha projektet e parapara të realizohen në të mirë të qytetarëve.

Jeton Mehmeti: - tha se buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2026, nuk është vetëm dokument financiar, por dokument politik që pasqyron prioritetet dhe vizionin për zhvillimin e kryeqytetit. Ai tha edhe pse parashihen investime të konsiderueshme në infrastrukturë urbane, sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural trajtohet në mënyrë minimale, me fonde të pamjaftueshme dhe mungesë të qartë vizioni për prodhim, përpunim dhe zhvillim tregu. Mehmeti theksoi se kjo qasje krijon zhvillim të njëanshëm dhe thellon pabarazitë mes qendrës urbane dhe zonave rurale të Prishtinës si: Mareci, Grashtica, Hajvalia, Bërnica e Mramori. Prandaj tha se mungesa e investimeve në infrastrukturë në zonat rurale pengon funksionalizimin e fermave dhe bizneseve familjare, duke nxitur braktisjen dhe migrimin drejt qytetit, e të cilat ndikojnë në rritjen e trafikut, mbingarkesën urbane dhe presionin mbi shërbimet publike. Ai tha se kërkoj rritje reale të buxhetit për bujqësi dhe zhvillim rural, investime konkrete në infrastrukturë lokale, mbështetje për prodhim dhe përpunim, si dhe integrim të plotë të zonave rurale në strategjinë zhvillimore të kryeqytetit.

Nora Klemedi: - tha se sot nuk po shqyrtojmë vetëm një tabelë shpenzimesh, por po vlerësojmë nëse ky buxhet ka vizion dhe përgjegjësi. Rritja e dyfishtë e shërbimeve kontraktuese, shtimi i mjeteve për rrënimin e objekteve pa leje, pajisjet gjeodezike, kontratat për konsulencë dhe mirëmbajtja e ashensorëve kërkojnë sqarime të qarta. Ajo tha se qytetarët duhet të dinë pse po rriten këto linja buxhetore dhe çfarë rezultatesh konkrete do të prodhojnë. Kelmendi deklaroi se transparenca dhe llogaridhënia janë thelbësore, sepse çdo euro e buxhetit duhet të justifikohet me rezultate të matshme dhe shërbim më të mirë për qytetarin.

Egzon Azemi:- deklaroi se mungesa e kryetarit Përparim Rama në seancën më të rëndësishme të vitit për buxhetin e Prishtinës është dëshmi e mungesës së seriozitetit institucional. Buxheti është rritur falë mbështetjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, por mënyra e shpërndarjes së mjeteve ngre shqetësime të mëdha. Azemi tha se ne kemi dy kërkesa dhe besojmë që do të hasim në mirëkuptim, kërkesa e parë është që 7 milionë euro të planifikuara për një projekt të kundërshtuar publikisht të ridestinohen tek Ndërmarrjet publike siq është “Pastrimi” dhe ndërmarrjet tjera komunale, në mënyrë që të shmanget falimentimi i tyre dhe të përmirësohet gjendja e pastërtisë në qytet, kërkesa e dytë është përfshirja e unazës së brendshme në projektbuxhet. Ai tha se nuk mund të arsyetohet ndarja e milionave për projekte të dyshimta, ndërkohë që qyteti përballet me mbeturina, mungesë investimesh në shkolla dhe nevoja bazike. Ai tha se nëse mjetet ridestinohen për ndërmarrjet publike dhe interesin e qytetarëve, do ta mbështesim buxhetin, në të kundërtën, nuk mund të bëhemi pjesë e një qasje që favorizon interesa të ngushta në dëm të qytetit.

Enver Redenica:- tha se ky buxhet i Prishtinës për vitin 2026 nuk i përmbush nevojat reale të qytetarëve, veçanërisht të lagjeve si “Sofalia”, “Tokëbashqë”, “Bledi”, “Tasligje”, “Velenia” dhe “Dodona” të cilat mbeten pa investime bazë si ujë i pijshëm, kanalizim dhe rrugë funksionale. Pishina e Gërmisë dhe infrastruktura e rrugëve në këto lagje janë lënë jashtë buxhetit, edhe pse kanë qenë premtime të përsëritura. Redenica deklaroi se ky buxhet i shërben interesave politike të koalicionit dhe jo qytetarëve, duke mbuluar borxhe dhe pazare të mëparshme, për këto arsye, nuk meriton mbështetjen time dhe besimin e qytetarëve.

Feim Osmani:- tha se buxheti i Prishtinës për vitin 2026 është mbi 151 milionë euro, dhe trajtohet me shumë pak diskutim dhe pa transparencë. Ai karakterizohet nga tri probleme kryesore: 1. Buxhet diskriminues për fshatrat e Prishtinës ku marrin vetëm 4.2% të investimeve kapitale, pavarësisht nevojave, numrit të banorëve dhe territorit. 2. Buxhet abstrakt dhe i paqartë pasi shumë linja për investime dhe shërbime janë të paqarta, përfshirë Drejtorinë e Parqeve, Zyrën e Personelit dhe Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe 3. Buxhet klientelist pasi që shpërndarja e mjeteve duket e motivuar nga interesa politike dhe jo nga nevojat reale të qytetarëve. Osmani deklaroi se paqartësit mbi shpenzimet e mëparshme dhe menaxhimin e këtij buxheti, është e pamundur të besohet se paratë do të përdoren në mënyrë profesionale dhe përfitimet do të arrijnë te qytetarët. Ai tha se ky projekt buxheti është i papranueshëm në formën aktuale pasi që ai nuk përfshin investime urgjente për ujësjellësin, rrugët e fshatrave si Rimanisht, Barilevë e Vranidoll dhe nuk adreson problemet e lagjeve rurale. Ky buxhet favorizon kontrata dhe pozicione politike, duke lënë qytetarët pa përfitime konkrete dhe duke treguar se nuk i përmbahet premtimeve ndaj komuniteteve dhe për këto arsye unë nuk do ta mbështes këtë buxhet.

Berita Abazi:- tha se shqyrtimi i buxhetit të Prishtinës për vitin 2026, ndonëse buxheti rritet për mbi 20 milionë euro, mirëqenia sociale mbetet pothuajse e paprekur. Sipas saj, mbi gjysma e buxhetit shpenzohet në paga, mallra dhe shërbime, pa ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Ajo kritikon investimet që i cilëson si “kozmetike urbane”, si 7 milionë euro për sheshin “George Bush”, ndërkohë që problemet me trafikun, çerdhet, arsimin dhe shërbimet sociale mbesin të pazgjidhura. Abazi ngre shqetësime për mungesë vizioni zhvillimor, transparence dhe përcaktim të prioritetëve të nevojave reale të qytetarëve.

Besart Krasniqi:- tha se gjatë analizës së buxhetit për vitin 2026 vërehet se shumë projekte janë të njëjta me ato të viteve të kaluara, por me ndryshime të mëdha në shuma. Ai kërkoi të di arsyen

pse kanë ndyshuar kostot për projekte të njëjta, Sheshi “Georg Bush” ka rritje prej 7 milionë eurosh, ndërtimi i therrtores dhe tregu i kafshëve nga 100 mijë euro janë bërë 1 milion euro, qendra multifunkionale për punë sociale rritet nga 820 mijë në 1 milion euro, nënkalimi i rrugës “Agim Ramadani” nga 1.8 milionë zbrit në 1.6 milionë euro dhe mendoj se këto lëvizje kërkojnë sqarim publik. Parku në Kodër të Trimave përmendet, por pa saktësim të vendodhjes, shkollat e premtuara në lagjet si “Kodër të Trimave”, “Kodrina” dhe “Projnie” nuk janë përfshirë në buxhet, as parkingu nëntokësor në Dardani. Krasniqi tha se lagje si “Kolovica”, “Medrese”, “Vneshta” dhe zona të tjera mbesin jashtë fokusit të investimeve. Shkolla në Shkabaj ka nevojë për ndërtim të ri, jo vetëm aneks, dhe lagjja ka nevojë urgjente për çerdhe. Ai deklaroi se buxheti karakterizohet me mungesë projektesh të reja, prandaj kërkohet më shumë angazhim, prezencë dhe përgjegjësi nga udhëheqja komunale për interesin e qytetarëve të Prishtinës sepse ne do të jemi aty ku është interesi i qytetarëve të Prishtinës.

Nexhmije Gjema:- deklaroi se nuk ka arsye për një seancë të jashtëzakonshme me afat vetëm tre ditë për miratimin e buxhetit të kryeqytetit, emergjenca justifikohet vetëm në raste fatkeqësish apo situatash të paparashikueshme e jo për planifikimin vjetor të komunës. Asnjë asamblist nuk është kundër miratimit të buxhetit, por është joserioze të pritet që 334 pika buxhetore të analizohen brenda tri ditëve, edhe një familje nuk e planifikon buxhetin e saj në këtë mënyrë, e lëre më një komunë me gjithë kompleksitetin e saj. Ajo tha se në këtë buxhet mungon një studim serioz demografik që do ta lidhte strukturën e popullsisë me alokimin e mjeteve. Planifikimi afatgjatë (10–20 vjeçar), si në vende të rajonit, nuk reflektohet këtu, ekziston frika se shpërndarja e mjeteve nuk bazohet në nevoja reale të qytetit dhe fshatrave, pensionistëve, rinisë dhe kategorive në nevojë. Ajo theksoi se shumë pika rikthehen pa sqarime publike të mjaftueshme siq është rasti me 1 milion euro për spitalin e qytetit, pa koordinim të qartë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe QKUK-në. Ajo theksoi se një projekt mund të duket estetikisht i mirë, por pa funksionalitet për qytetarët, po ashtu 50,000 euro për shtëpinë për mbrojtjen e fëmijëve në situata emergjente ngre dyshime serioze për realizueshmërinë e projektit. Problemi nuk është vota pro apo kundër, por mungesa e kohës, analizës serioze dhe planifikimit strategjik. Buxheti kërkon debat të thelluar, transparencë dhe përgjegjësi e jo ngutje procedurale.

Jeta Dida- Bujari:- tha se buxheti i kryeqytetit nuk është vetëm dokument financiar, por deklaratë prioritetesh dhe vizioni zhvillimor. Në formën aktuale, ai nuk krijon balancë mes zhvillimit urban dhe atij njerëzor, nga 40.9 milionë euro për arsim, mbi 71% shkojnë për paga dhe mëditje. Ajo tha se sistemi po mbahet në funksion, por nuk po zhvillohet e as transformohet. Vetëm 35,000 euro janë ndarë për trajnime profesionale të mësimdhënësve më pak se 0.1% e buxhetit të arsimit, po ashtu, 210,000 euro për digjitalizim janë të pamjaftueshme për reforma reale, në kontrast 7 milionë euro për sheshin “George Bush” tregojnë qartë se infrastruktura fizike po merr përparësi ndaj investimit në dije. Betoni po fiton mbi dijen. Jeta tha sa i përket arsimit artistik, ndërtimi i një Liceu Artistik nuk duhet ta zëvendësojë apo ta mjegullojë rolin e Shkollës së Mesme Artistike “Prenk Jakova” në Prishtinë, institucion me traditë 75-vjeçare që meriton investim dhe përkrahje të drejtpërdrejtë. Investimi në arsim dhe art nuk është luks, por investim në identitet, kulturë dhe zhvillim të qëndrueshëm të qytetit.

Mrika Limani:- theksoi se buxheti i vitit 2026 është dokument politik që tregon qartë prioritetet e pushtetit, edhe pse më i madh se në vitet paraprake, problemi nuk qëndron te mungesa e mjeteve, por te mënyra e shpërndarjes së tyre. Ajo tha se shohim një disproporcion të qartë më shumë mjete

për administratë dhe projekte të përsëritura, ndërsa mirëqenia sociale trajtohet me shuma minimale dhe me ndërhyrje të izoluar. Investimet përqendrohen në projekte simbolike dhe zona qendrore, pa një qasje të balancuar territoriale dhe pa politika mbështetëse për strehim të përbalueshëm. Limani deklaroi se kjo e rritë rrezikun e përjashtimit dhe thëllon pabarazinë urbane, lagje me densitet të lartë si “Mati 1”, “Dardania”, “Kolovica” dhe “Bregu i Diellit”, nuk trajtohen sipas peshës së tyre demografike dhe nuk shohim kriteret e qarta që e lidhin numrin e banorëve me nivelin e investimeve. Zhvillimi nuk matet me pamje, por me ndikimin real në jetën e përditshme të qytetarëve kurse një buxhet i drejtë është ai që i shërben shumicës e jo vetëm imazhit të qytetit.

Lumnije Mikullovc:- tha se sot diskutojmë për buxhetin katërvjeçar të Komunës së Prishtinës, ndërkohë që mungon kryetari i qytetit dhe nuk kemi një arsytim të qartë për këtë mungesë. Për një dokument kaq të rëndësishëm, përgjegjësia institucionale është thelbësore. Mikullovc theksoi se si përfaqësuese e komunitetit artistik, shpreh shqetësimin tim për nivelin e pamjaftueshëm dhe të paqartë të mbështetjes për artin dhe kulturën. Ajo tha se arti nuk është luks është investim në identitetin dhe zhvillimin e shoqërisë, pa mbështetje reale financiare, potenciali i artistëve dhe institucioneve kulturore të kryeqytetit mbetet i pashfrytëzuar, për këto arsye, unë nuk do ta votoj këtë buxhet. Shpresoj që të reflektojmë, sepse ajo që votojmë sot ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen e kryeqytetit.

Leutrim Retkoceri:- deklaroi se po flas si asamblist i Partisë Demokratike të Kosovës, edhe për shkak të disa spekulimeve që u përmendën këtu. Sot PDK është forca e dytë politike në Kuvendin e Kryeqytetit, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje është forca e tretë ky është një realitet politik që duhet pranuar. Ai tha sa i përket buxhetit, ne kemi kërkuar transparencë më të madhe, më shumë dëgjime publike dhe planifikim më të mirë, këto janë parime themelore, jo kërkesa partiake. Retkoceri u shpreh se buxheti nuk është i një partie të vetme, por i qytetarëve të Prishtinës, megjithatë në këtë situatë me afate të kufizuara dhe me rrezik bllokimi financiar, ne nuk duam që Prishtina të mbetet peng i përplasjeve politike, prandaj Partia Demokratike e Kosovës do ta votojë buxhetin jo sepse është ideal, por sepse përgjegjësia jonë është që qyteti të mos bllokohet dhe ne do të votojmë për qytetarët.

Gëzim Sveçla:- tha se Lëvizja Vetëvendosje nuk është kundër buxhetit si dokument. Ne jemi kundër projekteve me probleme ligjore dhe me pasoja për zhvillimin e drejtë të qytetit, të cilat janë pjesë e këtij buxheti. Gëzimi deklaroi se ky buxhet në formën aktuale, nuk garanton barazi mes lagjeve, nuk siguron zhvillim urban të drejtë dhe lë pas dore zonat rurale, për këtë arsye nuk mund ta mbështesim ashtu siç është. Ai tha ne kemi votuar buxhete edhe kur kemi qenë opozitë, kur ato i kanë shërbyer qytetit dhe qytetarëve. Sveçla tha se parimi ynë mbetet i njëjtë, nëse buxheti hapet për diskutim dhe rishikohen projektet problematike, ne jemi të gatshëm ta votojmë, por në formën si është sjellë sot, nuk kemi votë për këtë buxhet.

Leutrim Retkoceri:- tha se dallimi nuk bëhet me bllokada, por me përfaqësim të qytetarëve dhe respektim të parimeve. Ne kemi kërkuar transparencë dhe raport të auditorit, pa qenë kurrë bllokues. Ai deklaroi se sot situata është e qartë ose votohet buxheti dhe i jepet mundësi qytetit të funksionojë, ose tentohet të krijohet një bllokadë politike, kështu që Partia Demokratike e Kosovës nuk do të lejojë që buxheti të përdoret nesër si arsye për bllokim të qytetit.

Vendimi për miratimin e buxhetit të Kryeqytetit për vitin 2026, u miratua me 33 vota për, 8 vota kundër dhe asnjë abstenim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:48.

**Procesmbajtësi
Skender Tora**

**Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 27.2.2026, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: : Fehmi Kupina, (Lidhja për Prishtinën), kryesues i Kuvendit, Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida Bujari (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumnije Mikullovc (LVV), Leonora Shabani - Bajraktari (LVV), Kreshnik Smajllaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (Nisma), Jeton Mehmeti (Guxo), Valbona Ajeti (AAK).

Munguan: Etnik Mustafa (LDK), Ilirik Musliu (PDK), Mrika Limani Myrtaj (LVV), Berita Abazi Muhadri (LVV), Enver Redenica (LVV), Yll Bogaj (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, Kryetar i Kryeqytetit, Shkëmb Manaj, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Sokol Havolli, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Gëzim Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Florent Maliqi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit dhe Mjedisit, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Bekim Brestovci drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësis, Samir Shahini, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Donat Gashi, drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili i njoftoi të pranishmit për një ndryshim që ka ndodhur në përbërje të këshilltarëve të

Kuvendit, ku pas dorëheqjes së Egzon Azemit nga radhët e LVV, atë e zëvendëson këshilltari i ri Çlirim Gërbeshi, nga radhët e LVV-së, i cili bëri betimin sipas legjislacionit në fuqi.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozoi këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverballi të seancës inauguruese dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 3. Propozim-vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026;**
- 4. Propozim-Vendimi për bartjen e 45 normave, pozitive nga niveli i arsimit të mesëm në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët;**
- 5. Miratimi i rregullores për caktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për më pak se një vit, sipas rekomandimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;**
- 6. Miratimi i ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**
- 8. Të ndryshme.**

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Osman Bllaca tha se në vend të miratimit të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, propozohet propozim-vendim për dërgimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Prishtinës në diskutim publik, ndërsa miratimi i saj do të bëhet pas përfundimit të diskutimit publik.

Kryetari propozon që Komuna e Prishtinës të mbështesë programin e bursave Chevening Scholarships, përmes financimit të dy granteve shtesë nga 20.000 euro, në vlerë totale prej 40.000 euro. Kontribut ky që synon të plotësojë mbështetjen ekzistuese për studentët e Kosovës që ndjekin studime pasuniversitare në United Kingdom, veçanërisht në fusha strategjike, si inteligjenca artificiale dhe Big Data, duke investuar në zhvillimin afatgjatë të Prishtinës dhe të vendit.

Gëzim Sveçla paraqiti shqetësim lidhur me vonesën e mbajtjes së seancës së parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe për mungesën e trajtimit të disa çështjeve të rëndësishme, si raporti i auditimit, rregullorja e “Prishtina Parking”, mungesa e raportimit të kryetarit para Kuvendit dhe mungesa e transparencës në publikimin e emërimeve në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës. Sveçla deklaroi në emër të LVV-së, se ofron mbështetje për çdo vendim që është në interes të qytetit, pa kushte politike. Ai propozoi shtimin e një pike në rend dite: “Diskutim mbi situatën me mbeturinat në kryeqytet”, ndërsa për

propozimin e bërë nga z. Rama, shpreh mbështetje parimore, me kusht që të sigurohen materiale shpjeguese dhe sqarime ligjore për përdorimin e fondeve publike.

Shkëmb Manaj, nënkryetar, kërkoi që të tërhiqet pika e pestë e rendit të ditës: Miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Prishtinës, më pak se një vit, sipas rekomandimit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, për shkak se ju duhen disa konsultime shtesë me Drejtorinë e Pronës.

Nora Kelmendi pyeti nënkryetarin lidhur me tërheqjen e pikës së pestë nga rendi i ditës: Projektregulloren për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhë më pak se një vit. Ajo theksoi se kjo rregullore është sjellë në Kuvend që nga viti 2023 dhe ka kaluar disa herë në procedurë, konkretisht më 17 nëntor 2023 dhe më 14 tetor 2024, pavarësisht se rekomandimet nga MAPL janë pranuar më 9 janar 2024 dhe kanë kaluar rreth tre vjet dhe ende nuk janë adresuar çështjet ligjore të kësaj rregulloreje. Nora kërkoi sqarim nga ekzekutivi për arsyet e tërheqjes së pikës nga rendi i ditës, duke thënë se sipas grupit të saj, rregullorja nuk duhet të hiqet nga rendi i ditës pa një arsyetim të qartë. Ajo shtoi se nëse është e nevojshme që projektregullorja të dërgohet sërish në diskutim publik, kjo është e pranueshme, por duhet të jepet një arsyetim i qartë për këtë veprim.

Shkëmb Manaj, nënkryetar, sqaroi se projektregullorja është trajtuar më herët në Kuvend, por pas rekomandimeve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është kërkuar rishikimi i disa dispozitave. Ai theksoi se rekomandimet kanë të bëjnë me mënyrën e dhënies në shfrytëzim të banesave dhe lokaleve, si dhe me çështjen e tarifave që nuk janë në përputhje me rregulloren ekzistuese për tatimet dhe me çmimet e tregut. Ai deklaroi se Drejtoria e Pronës ka propozuar disa ndryshime dhe shtesa të tjera në këtë rregullore dhe pas konsultimeve me Zyrën ligjore, planifikohet që në një nga seancat e radhës të procedohen për shqyrtim dy rregullore njëkohësisht.

Nexhmije Gjema, përgëzoi kryetarin për iniciativën lidhur me projektin për varrezat e kryeqytetit, duke e vlerësuar atë si një model të barabartë dhe institucional, të mirëpritur nga qytetarët, megjithatë kërkoi sqarime shtesë lidhur me detajet e projektit, pasi sipas saj ka paqartësi rreth pronës dhe procedurave të ndërrmarra. Ajo shprehu edhe shqetësimet e ngritura nga Kisha Protestante lidhur me këtë çështje, dhe theksoi se projekti është i rëndësishëm dhe i mirëpritur për të gjithë qytetarët dhe bashkësitë fetare.

Kryetari theksoi se çështja e varrezave të kryeqytetit është një temë me rëndësi të madhe për qytetin dhe qytetarët. Gjendja aktuale e varrezave nuk është në nivelin e duhur, andaj kërkohet përmirësim. Sipas tij, Komuna ka zhvilluar diskutime me komunitetet fetare, me qëllim krijimin e një modeli të përbashkët dhe modern të varrezave, duke respektuar ritet e secilit besim dhe nevojat e të gjithë qytetarëve. Po ashtu, u bë e ditur se planifikohet edhe organizimi i një konkursi ndërkomëbëtar për zgjidhjet e dizajnit dhe menaxhimit të varrezave.

Besa Shahini kërkoi që gjatë rishqyrtimit të Projektregullores të dorëzohet edhe një dokument përcjellës që tregon mënyrën se si janë adresuar komentet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Besa theksoi se komentet e MAPL-së nuk janë shpërndarë më herët te asamblistët, duke iu referuar Statutit të Kuvendit Komunal, kërkoi nga ekzekutivi që të dërgojë përgjigje me

shkrim për kërkesën e bërë më parë lidhur me planin e punës për adresimin e të gjeturave të auditorit për keqmenaxhimin e pronës publike.

Kryesuesi konstatoi se më 43 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u miratua propozimi i kryetarit Rama për pikë të rendit të ditës “Propozim-Vendimit për subvencionimin e studentëve të programit të bursave Chevening në fushën e inteligjencës artificiale dhe Big Data”.

Kryesuesi konstatoi se më 15 vota për, 25 kundër, 2 abstenime, nuk u miratua propozimi i Gëzim Sveçlës për pikë të rendit të ditës: “Diskutim lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar me mbeturinat në kryeqytet”.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u miratua rendi i ditës me ndryshime.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës inauguruese dhe të seancave të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se me 42 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të seancës inauguruese dhe të seancave të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim - vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Jeta Rafuna, në emër të grupit të LDK-së, propozoi Jeta Rafuna Hasani, Dhurata Jahaj Retkoceri dhe Amir Simnica.

Leutrim Retkoceri sqaroi se grupi i Partisë Demokratike të Kosovës mbështet formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ndarjen e vendeve në të, duke theksuar se propozimet duhet të shqyrtohen fillimisht në Komitet përpara se të procedohen në Kuvend. Retkoceri theksoi se nuk mund të pranojnë zgjedhjen e anëtarëve me short, pasi që duhet t'i referohemi rezultatit të zgjedhjeve dhe numrin e votuesve, ku PDK ka 556 votues më shumë se subjekti i tretë. Ai kërkoi që kolegu Agron Canolli të sqarojë në detaje argumentin ligjor dhe propozimet për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agron Canolli elaboroi rëndësinë e formimit të Komitetit për Politikë dhe Financa si mekanizëm kyç të Kuvendit dhe theksoi se ndarja e vendeve duhet të bëhet mbi bazën e përfaqësimit proporcional sipas Metodës së Dehontit. Canolli shpjegoi se Komiteti ka 11 anëtarë, ku 10 vendet ndahet proporcionalisht ndërmjet subjekteve politike, bazuar në kalkulimet dhe dispozitat ligjore për barazi, përfaqësimi final është: LDK – 3 anëtarë, PDK – 3 anëtarë, LVV – 2 anëtarë, AAK – 1 anëtar dhe Lidhja për Prishtinën – 1 anëtar.

Gëzim Sveçla theksoi se ndarja e vendeve në Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të bëhet sipas përfaqësimit në Kuvend, bazuar në numrin e mandateve të fituara, dhe jo mbi baza të tjera ose interpretime të papërshtatshme të ligjit. Sveçla sqaroi se përfaqësimi është: LDK – 3 vende, PDK – 2 vende, LVV – 2 vende, AAK – 1 vend dhe Lidhja për Prishtinën – 1 vend, ndërsa vendi i mbetur ndahet me short ose me rrotacion ndërmjet PDK-së dhe LVV-së, ndërsa çdo devijim nga ky dakordim rrezikon bllokimin e komitetit dhe funksionimin e Kuvendit.

Erblina Tahiraj deklaroi se grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës propozon Kreshnik Smajlajn si anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Arbenita Murseli Haxholli deklaroi se Grupi i Lidhjes për Prishtinën propozon Betim Abdullahun si anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi kërkoi nga dy partitë që të propozojnë emrat e kandidatëve për Komitetin për Politikë dhe Financa, duke sqaruar se nëse nuk arrihet pajtimi, çështja mund të dërgohet në ministri për opinion ligjor. Ai theksoi se propozimet duhet të jenë në përputhje me dakordësinë e arritur në diskutimet e mëparshme.

Besianë Musmurati- deklaroi se PDK-ja i sqaroi arsyet për të cilat partisë së saj i takojnë 3 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe propozon emrat: Leutrim Retkoceri, Fjolla Vukshinaj dhe Agron Canolli.

Gëzim Sveçla kritikoi vonesat dhe mosmarrëveshjet lidhur me formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, duke theksuar se nuk duhet të pengohet procesi nga interesat e grupeve politike. Ai kërkoi sqarime nga institucionet kompetente të Komunes së Prishtinës mbi mënyrën e propozuar dhe procedurat ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të komitetit.

Granit Geci theksoi se procesi i formimit të Komitetit për Politikë dhe Financa është i thjeshtë dhe i qartë, duke respektuar vullnetin e qytetarëve dhe ligjin. Ai njoftoi se grupi i tij ka dhënë propozimet e veta dhe është i gatshëm t'i mbrojë këto vendime edhe përmes institucioneve kompetente ose gjyqësorit, nëse është e nevojshme, duke u bazuar në praktikën dhe formulat që përdoren në institucionet kredibile të Republikës së Kosovës.

Feim Osmani-theksoi se formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të bëhet në përputhje me parimin e përfaqësimit dhe marrëveshjen e arritur më parë, duke shmangur dërgimin e një komiteti me anëtarë jashtë normave ligjore në ministrinë përkatëse. Osmani kërkoi që çështja të trajtohet dhe diskutohet sot në Kuvend, duke siguruar që përbërja e komitetit të jetë ligjore dhe e pranueshme për institucionet kompetente.

Leutrim Retkoceri deklaroi se për çështjen e formimit të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të respektohet ligji dhe parimi i përfaqësimit proporcional, duke përdorur Metodën e Dehontit dhe kalkulimet e prezantuara në Excel nga grupi i PDK-së. Retkoceri propozoi që të hidhen në votim të dy propozimet e grupeve politike, duke shmangur përdorimin e shortit, dhe nënvizoi se Komiteti duhet të funksionalizohet pa bllokime, duke garantuar përfaqësimin e drejtë të Partisë Demokratike të Kosovës me tre anëtarë.

Gëzim Sveçla theksoi se Lëvizja Vetëvendosje propozon: Nora Kelmendin, Gëzim Sveçlën dhe Berita Abazi Muhadrin si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke theksuar se argumentet e tyre bazohen në udhëzimin administrativ për formimin e komiteteve të përhershme dhe duke kërkuar që çështja të avancojë pa bllokime.

Leutrim Retkoceri tha se, edhe pse mund të kërkohe mendimi i MAPL-së, vonesat nuk duhet të pengojnë formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne nuk e pranojmë përdorimin e shortit për të vendosur përfaqësimin e PDK-së dhe Vetëvendosjes, duke nënvizuar se duhet respektuar vullneti i qytetarëve dhe ligji, dhe se çdo shkelje ligjore mbart përgjegjësi për ata që e kryejnë atë.

Gëzim Sveçla theksoi se numri i votave të qytetarëve nuk ndikon në formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, pasi ndarja e vendeve bëhet mbi bazën e mandateve të fituara në Kuvend. Sveçla theksoi se çdo vonesë ose bllokadë nga PDK-ja pengon funksionimin e komitetit dhe se rastet e barazimit të mandateve zgjidhen përmes marrëveshjes politike ose shortit, siç praktikohet në institucione të tjera në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi njoftoi se do t'i hedhë në votim dy propozimet: fillimisht propozimin e z. Retkoceri, pastaj propozimin e z. Sveçla. Nëse nuk arrihet pajtim, do t'i drejtohet MAPL-së (Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal) për sqarim.

Gëzim Sveçla shprehi keqardhje ndaj kryesuesit, duke e akuzuar se po bie nën presionin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe po vepron në kundërshtim me ligjin. Ai theksoni se çështja është e rregulluar me udhëzim administrativ dhe se nuk ka paqartësi ligjore. Në shenjë kundërshtimi, deklaroi se ata nuk do të marrin pjesë në asnjë nga votimet, pasi i konsiderojnë ato shkelje ligjore.

Kryesuesi njoftoi të pranishmit që pasi nuk ka marrëveshje në mes të subjekteve politike për kandidatin e 11-të për KPF-në, propozon që kandidati i 11-të të zgjidhet me short. Kryesuesi e hedh në votim propozimin e tij. ku më 26 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim u miratua propozimi i kryesuesit.

Leutrim Retkoceri deklaroi se partia nuk e pranon që përzgjedhja e anëtarit për Komitetin për Politikë dhe Financa t'i nënshtrohet votimit, duke argumentuar se rezultati i zgjedhjeve e ka vendosur PDK-në parti të dytë me më shumë vota se Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë. Ai thekson se PDK do ta ndjekë këtë çështje në instanca të tjera, deri në gjykatë nëse është e nevojshme, megjithatë, nënvizon se partia respekton institucionet dhe proceset demokratike dhe nuk synon të bllokojë institucionet komunale.

Kryesuesi theksoi se pas hedhjes së shortit kandidati i tretë i takon Partisë Demokratike të Kosovës.

Leutrim Retkoceri deklaroi se, edhe pse vendi i 11-të i ka takuar Partisë Demokratike të Kosovës përmes shortit, ata mbeten të bindur se kjo pozitë duhet të përcaktohet sipas formulës së përfaqësimit dhe jo me short. Ai theksoi se, pavarësisht rezultatit aktual, çështjen do ta dërgojnë në gjykatë për të sqaruar përfundimisht parimin, në mënyrë që vullneti i qytetarëve të mos vendoset me short në kuvendet komunale.

Gëzim Sveçla propozoi Nora Kelmendin dhe Gëzim Sveçlën.

Osman Billaca tha se KPF-ja përbëhet nga 11 anëtarë, por nga 10 anëtarët e propozuar, 4 janë gra Jeta, Dhurata, Fjolla dhe Nora. Billaca i njoftoj se me këtë përbërje nuk mund të dërgohet lista në MAPL, për shkak të mosplotësimit të kuotës gjinore. Kërkohej që një nga burrat të zëvendësohet me një grua për të përmbushur normën e kuotës gjinore.

Betim Abdullahu tha se plotësimi i kuotës gjinore duhet të bëhet nga partitë që kanë dy ose më shumë anëtarë të propozuar, jo nga një parti që ka vetëm një përfaqësues, prandaj përgjegjësia bie te partitë më të mëdha që kanë më shumë anëtarë të propozuar.

Kryesuesi kërkoi nga Leutrimi se a mund të reflektojnë? Nëse jo, ne do të reflektojmë, ne jemi të hapur dhe të gjerë në perspektivë.

Betim Abdullahu tha se ne mund të reflektojmë, por ligjërisht PDK-ja është dashur të reflektojë. Lidhja e Prishtinës propozon Arbenita Murseli Haxholli për anëtar të KPF-së.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 1 kundër edhe 11 abstenime u miratua vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e tretë

Propozim-Vendimi për caktimin e grupeve punuese për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026.

Jeta Rafuna tha se në emër të grupit të asamblistëve të LDK-së propozojmë zonjën Rifadie Sopi.

Leutrim Retkoceri tha se Partia Demokratike e Kosovës e propozon asamblisten Arbnora Ajeti.

Gëzim Sveçla tha se Lëvizja Vetëvendosje e propozon Çlirim Gërbeshin.

Kreshnik Smalaj tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e propozon Erblina Tahiraj.

Betim Abdullahu tha se Lidhja e Prishtinës propozon Teuta Kadiu-Gjinolli.

Shkëmb Manaj nga ekzekutivi propozon Sokol Havollin për anëtar të komisionit.

Kryesuesi tha se nga Sektori për punë të Kuvendit e propozoj Luljeta Selimin, dhe nga Zyra ligjore Djellon Gjonbalaj.

Endrit Zabërgja u shpreh se së pari, më intereson të dijë pse tri partitë tona nuk morën të drejtën e propozimit dhe përfaqësimit në këtë grup punues, duke pasur parasysh që në mandatin e kaluar kemi qenë pjesë e tij dhe kemi kontribuar në planin e punës. Zabërgja tha se është e rëndësishme që të trajtohem si subjekte të ndryshme politike dhe të respektohen të drejtat tona legjitime për përfaqësim. Gjithashtu, dëshiroj të nënvizoj nevojën për më shumë seriozitet në punën e grupit, duke përfshirë edhe udhëheqjen e kryesuesit të Kuvendit në këtë proces. Ai tha se planifikimi i qartë i seancave dhe çështjeve për diskutim është i domosdoshëm, ashtu si transparenca ndaj

qytetarëve dhe informimi i aksionarëve të ndërmarrjeve publike. Uroj që të mos harrohen tri partitë tona, të cilat kanë përfaqësim dinjitoz dhe meritojnë të respektohen.

Kryesuesi tha se do të veprojmë siç u propozua dhe do të përfshihen të gjithë, edhe pse disa nuk kanë grup të formalizuar, dhe kërkon deklarin nëse edhe PSD dhe Lista Guxo pajtohen të jenë pjesë e grupit punues.

Besa Shahini tha se Rregullorja nuk e kërkon domosdoshmërisht përfaqësimin e partive të vogla, por mbetet në vlerësimin tuaj nëse pjesëmarrja jonë i shërben punës.

Kryesuesi propozoi që të gjithë të përfshihen në përfaqësim.

Kryesuesi konstatoi se, më 38 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e grupeve punuese për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026.

Pika katërt

Propozim-Vendime për bartjen e 45 normave pozitive nga niveli i arsimit të mesëm në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët.

Samir Shahini theksoi se Drejtorja e Arsimit kërkon mbështetjen e Kuvendit për bartjen e disa normave të lira nga arsimit i mesëm i lartë, nevoja ka ardhur për shkak të rritjes së kapaciteteve në institucionet parashkollore dhe fillore. Shahini deklaroi se hapja dhe zgjerimi i disa kopshteve kanë krijuar nevojë për staf shtesë dhe sipas ligjit për buxhet, kërkohet edhe vendim i Kuvendit Komunal për këtë ndryshim, prandaj propozoj bartjen e 45 normave, 20 në arsimin parafillor dhe 25 në arsimin fillor.

Rifadije Sopi, në emër të grupit të LDK-së, shprehu mbështetje për vendimin e bartjes së 45 normave nga arsimit i mesëm i lartë në arsimin parafillor dhe fillor, bazuar në analizën e nevojave reale. Ky riorganizim synon shpërndarje më të drejtë të stafit dhe forcimin e arsimit parafillor dhe fillor, në interes të fëmijëve dhe familjeve të kryeqytetit.

Besianë Musmurati shprehu shqetësimin se, nëse bartja e normave nga shkollat e mesme në ato fillore mund të krijojë mungesë stafi në arsimin e mesëm, veçanërisht në shkollat si ajo e muzikës. Andaj sugjeroi që përveç këtij riorganizimi, Komuna të kërkojë nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave rritjen e numrit të normave për Prishtinën.

Samir Shahini bëri të ditur se kërkesa për rritjen e grantit specifik nga Ministria e Arsimit për institucionet parafillore në Prishtinë është përsëritur disa herë, por ende nuk ka marrë përgjigje. Ndërkohë, në arsimin e mesëm, numri i nxënësve ka rënë dhe bartja e normave nuk do të cenojë kapacitetet ekzistuese, duke ruajtur rezerva për nevojat e mundshme në të ardhmen.

Leonora Shabani tha se propozimi për transferimin e 45 normave nga arsimit i mesëm në nivelin parafillor dhe fillor, synon riorganizimin e kapaciteteve sipas nevojave të shkollave dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Leonora deklaroi se Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje mbështet

vendimin, por kërkon më shumë transparencë dhe raporte analitike të detajuara për vendime të tilla, duke theksuar rëndësinë e llogaridhënies dhe planifikimit afatgjatë në arsimin e kryeqytetit.

Erblina Tahiraj deklaroi se grupi mbështet propozim-vendimin, duke theksuar se shpërndarja e normave duhet të bazohet në nevojat reale të nxënësve dhe institucioneve, me analiza të sakta dhe transparente, pa dëmtuar cilësinë e arsimit në asnjë nivel.

Betim Abdullahu bëri të ditur se Grupi i Lidhjes së Prishtinës e mbështet bartjen e normave për të siguruar funksionim të mirë dhe të qëndrueshëm të shkollave dhe procesit mësimor në kryeqytet.

Besa Shahini deklaroi se e mbështet kalimin e 45 normave, por shqetësimi kryesor mbetet arsimit parashkollor në Prishtinë, i cili mbulon vetëm 10% të nevojave reale. Problemet kryesore janë mungesa e hapësirave dhe mbingarkesa e shkollave, që ndikojnë negativisht në cilësinë e mësimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve. Besa sugjeron adaptimin e hapësirave ekzistuese për kopshte dhe çerdhe, rishikimi i orarit mësimor dhe krijimi i një plani të qartë për menaxhimin e arsimit parashkollor dhe fillor në qytet.

Valbona Ajeti theksoi se vjen nga sektori i arsimit dhe e mbështet fuqishëm bartjen e normave, duke marrë parasysh rritjen e kapaciteteve të institucioneve parashkollor dhe shtimin e numrit të fëmijëve, si dhe nevojën për funksionimin e rregullt të procesit edukativo-arsimor.

Fadil Aliu u shpreh në mbështetje të bartjes së normave, sidomos në arsimin parafillor, duke theksuar se rritja e numrit të fëmijëve dhe nevojat e kryeqytetit kërkojnë shfrytëzim të numrave të caktuar nga Ministria e Arsimit. Aliu shprehet se plotësimi i këtyre normave është i domosdoshëm për të mundësuar funksionimin e plotë të institucioneve arsimore, pavarësisht kapaciteteve buxhetore, sepse numrat e stafit përcaktohen nga niveli qendror dhe kërkon që ato të përditësohen sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Gëzim Sveçla theksoi se normat e propozuara për institucionet e reja parashkollore e përfshijnë edhe kopshtin e ri që pritet të hapet në lagjen “Kolovica e Re”, duke theksuar se arsyetimi nuk është përditësuar pasi çerdhet në lagjet “Dardania” dhe “Pejtoni” tashmë janë funksionale. Njëherësh u kërkua sqarim për statusin e drejtorit që po prezanton, nëse është emëruar në mandatin e ri apo vazhdon nga mandati i kaluar.

Samir Shahini i falënderoi të gjitha grupet parlamentare për mbështetjen dhe bashkëpunimin rreth kësaj çështjeje, duke theksuar rëndësinë e unitetit, pavarësisht përkatësisë politike, ai po ashtu sqaroi se propozimi është përditësuar dhe është i njëjti që ka kaluar vitin e kaluar në Komisionin për Politikë dhe Financa, pasi rrethanat nuk kanë ndryshuar. Shahini theksoi se objekti i ri në lagjen “Kolovica”, nuk është përfshirë në këtë kalkulim, por mund të shfrytëzohet përmes një riorganizimi të normave ekzistuese. Ai tha se kapaciteti i paraparë mund të mos i përmbushë të gjitha kërkesat dhe se për këtë nevojitet një analizë shtesë, pasi kopshti ende nuk është funksional dhe tha se ushtrimi i detyrës së drejtorit bëhet mbi bazën e një vendimi të vlefshëm.

Shkëmb Manaj u përgjigj lidhur me pyetjen e zotit Sveçla. Sa për informim të anëtarëve të Kuvendit dhe qytetarëve të Prishtinës, nënkryetarët dhe të gjithë drejtorët tashmë kanë vendime në mandatin e ri të z. Rama dhe se ato pritet të publikohen së shpejti.

Besianë Musmurati u shpreh se duhet një qasje konstruktive përtej debateve politike, me fokus te qytetarët dhe shërbimet që ata marrin, nëse Komuna e Prishtinës planifikon ndërtimin e çerdheve të reja ose zgjerimin e hapësirave në shkolla, është e domosdoshme edhe përditësimi i stafit. Besiana po ashtu theksoi se kjo ka qenë një problematikë e vazhdueshme ndër vite dhe u bën thirrje që, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, të dërgohet një kërkesë në ministri për ta shtyrë përpara këtë çështje në të mirë të qytetarëve të Prishtinës.

Feim Osmani tha se nevoja për norma të reja në arsimin parafillor dhe fillor nuk vihet në dyshim, megjithatë u vlerësua se kërkesa e paraqitur do të duhej të ishte shoqëruar me një raport sqarues, në mënyrë që anëtarët e Kuvendit të kenë një bazë më të plotë për diskutim dhe vendimmarrje. Osmani theksoi se kërkesat drejtuar Ministrisë së Arsimit duhet të jenë të detajuara dhe të përmbajnë specifika të qarta lidhur me institucionet për të cilat kërkohet shtimi i normave, veçanërisht në arsimin parafillor, duke pasur parasysh rritjen e numrit të çerdheve dhe nevojën për staf të ri. Ai kërkoi sqarim për mënyrën se si është adresuar kërkesa në ministri dhe çfarë përgjigjeje ka marrë Komuna, me qëllim që kjo çështje të trajtohet në mënyrë institucionale dhe jo politike.

Fadil Aliu- deklaroi se Komuna e Prishtinës nuk ka kërkuar rritje të buxhetit, pasi përditësimi i tij është bërë në mënyrë automatike si rezultat i aplikimit të të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, dhe duke u bazuar në këtë regjistrim, Komunës së Prishtinës i shtohen rreth 800 vende pune shtesë, të cilat konsiderohen të domosdoshme për funksionimin e sektorëve si arsimit, çerdhet dhe qendrat e mjekësisë familjare. Aliu tha se pavarësisht kërkesave të vazhdueshme drejtuar ministrisë përkatëse për shtimin e normave, kjo nuk ka ndodhur dhe si shembull u përmend kërkesa e vitit 2024 për rekrutimin e psikologëve, ku Komuna është obliguar të bëjë punësimin, por pa u reflektuar shtimi i numrit të tyre nga ministria, dhe në këtë kontekst u theksua se funksionalizimi i çerdheve të reja është i vështirë pa shtimin e stafit të nevojshëm nga niveli qendror.

Feim Osmani bëri të ditur se Ministria është bazuar në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë për ndarjen e grantit për arsim, duke reflektuar rritjen e numrit të popullsisë, dhe në këtë kontekst, u vlerësua se Drejtoria e Arsimit do të duhej të kishte dërguar kërkesa dhe raporte të detajuara me specifika të qarta për normat e nevojshme. Osmani kërkoi sqarim nga drejtori përkatës lidhur me kërkesat e dërguara gjatë periudhës 2024–2025 dhe përgjigjet e marra nga ministria, me qëllim që anëtarët e Kuvendit të informohen saktë mbi hapat institucionalë të ndërmarrë dhe çështja duhet trajtuar në mënyrë bashkëpunuese, duke pasur parasysh se askush nuk ka interes ta dëmtojë Prishtinën në aspektin e arsimit.

Kryesusi konstatoi se më 39 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u miratua Vendimi për bartjen e 45 normave, pozitive nga niveli i arsimit të mesëm në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët.

Pika e pestë

Propozim - Vendimi për subvencionimin e studentëve të programit të bursave në fushën e inteligjencës artificiale dhe Big Data, në vlerë prej dyzetmijë euro, (40.000).

Shkëmb Manaj u shpreh se propozimi për ndarjen e 40,000 eurove nga kategoria e subvencioneve, të cilat lidhen me bursa ndërkombëtare, u paraqit në fillim të seancës nga kryetari i Kryeqytetit me arsyetimin përkatës. Ai kërkoi nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta miratojnë propozimin në bazë të këtij arsyeimi.

Feim Osmani theksoi se pika e propozuar nga kryetari Rama, ka për qëllim ndarjen e 40,000 eurove nga buxheti i Kryeqytetit si subvencion për bursa, që mund të përfshijnë qytetarë nga të gjitha komunat e Kosovës, jo vetëm nga Prishtina. Osmani deklaroi se mungesa e dokumentacionit dhe sqarimeve nga kryetari për pjesëmarrjen e institucionit donator dhe për mbulimin aktual të bursave, duke kërkuar informacion shtesë nëse ka mungesë të fondeve nga organizatori ose donatori kryesor, sa është shuma që duhet plotësuar në këtë rast. Ai tha se nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme, prandaj diskutimi i mëtejshëm është i nevojshëm për të vendosur mënyrën e votimit nga asamblistët dhe për të siguruar transparencë lidhur me përdorimin e mjeteve publike për arsimin specifik, përfshirë fushat si inteligjenca artificiale.

Erblina Tahiri tha se Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështesim fuqishëm këtë pikë.

Arbenita Murseli Haxholli tha se Lidhja e Prishtinës e përkrah propozimin e kryetarit për ndarjen e bursave për studentët që do të studiojnë në Mbretërinë e Bashkuar, por kërkon sqarime shtesë lidhur me vendimin, sepse nuk duhet të votohet menjëherë pa u kuptuar procedura dhe rrjedha e mëtejshme deri në ekzekutimin e bursave.

Besa Shahini pyeti nënkryetarin lidhur me bursat, se a do të jenë të obliguar studentët të kthehen dhe të punojnë për institucionet publike të Komunës së Prishtinës pas përfundimit të studimeve, dhe cilat janë mekanizmat e monitorimit për të siguruar këtë dhe në çfarë forme do të mbikëqyren kontratat për të garantuar që investimi në arsim kthehet në shërbim të Komunës, duke marrë shembull nga praktikat e dhënies së bursave nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës. Shahini kërkoi të paraqiten sqarime shtesë në mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që asamblistët të mund ta votojnë të informuar dhe të sigurohet që studentët kontribuojnë në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e punëve të Komunës.

Endrit Zabërgja u shpreh se bursat për të rinjtë e Prishtinës janë jo vetëm të nevojshme, por edhe të domosdoshme për mbështetjen financiare dhe institucionale të tyre në arritjen e qëllimeve akademike. Edhe pse dokumentacioni mund të mos jetë plotësisht i përgatitur, kjo nuk duhet të ndalojë mbështetjen e iniciativave të mira, pasi organet komunale mund të rregullojnë detajet, përfshirë kontratat. Zabërgja theksoi rendësinë e fokusit të Kuvendit Komunal në mbështetjen e të rinjve, veçanërisht në fusha inovative, si inteligjenca artificiale, Ai vlerësoi rolin e Drejtorisë së Rinisë, Drejtorisë së Arsimit dhe të gjitha drejtorive komunale për të aftësuar të rinjtë në teknologji moderne. Ai tha se Nisma Social Demokrate e mbështet plotësisht iniciativën dhe angazhohet të japë kontribut për forcimin profesional të të rinjve të kryeqytetit.

Nora Kelmendi theksoi se u ngritën pyetje për nënkryetarin lidhur me ndarjen e bursave, duke theksuar se Komuna e Prishtinës vetëm do të sigurojë 40,000 euro, ndërsa ndarja e bursave po

bëhet pa thirrje publike dhe vetëm me vendim të Kuvendit të Kryeqytetit. Ajo përmendi gjetjet e auditorit për vitet 2022, 2023 dhe të fundit, ku vendimet për ndarje e subvencioneve dhe mbështetje të OJQ-ve janë të jashtëligjshme, për shkak të mungesës së thirrjeve publike. Nora kërkoi dokumentacion shtesë për të parë nëse vendimi është jashtëligjor dhe asamblastët nuk mund ta votojnë derisa të sqarohet situata ligjore.

Shkëmb Manaj bëri të ditur se nuk ka buxhet shtesë për këtë iniciativë. Fondi vjen nga buxheti ekzistues i subvencioneve të Kryetarit, i cili ka të drejtë të ndajë pjesë të këtij buxheti, por për shkak të shumës së bursave (dy kuota), Kryetari ka kërkuar miratimin e Kuvendit për ndarjen e tyre. Ai theksoi se mbështetja nga Kuvendi është për dy kuota shtesë, ndërsa procedurat e ndarjes dhe zbatimit të bursave zhvillohen nga programi përkatës dhe për këto dy kuota, kërkohet që përparësi të kenë studentët e Komunës së Prishtinës, në kuadër të programit të bursave.

Fadil Aliu bëri të ditur se bursat menaxhohen nga Ambasada britanike, përmes programit Chevening, Foreign Commonwealth Office – FCO, ku përzgjedhja dhe thirrja për aplikim bëhen nga Ambasada, sipas procedurave të saj transparente dhe online. Aliu deklaroi se Kuvendi duhet të vendosë vetëm për mbështetjen e dy bursave nga ky program, të cilat i shtojnë dy të tjera, duke krijuar gjithsej katër bursa, prandaj kërkoj që përfituesit e dy bursave të propozuara të jenë qytetarë të Komunës së Prishtinës nga fushat e parashikuara, ndërsa procedurat e përzgjedhjes dhe kriteret e aplikimit janë të vendosura nga Ambasada britanike.

Gëzim Sveçla- ngriti shqetësimin lidhur me aspektin ligjor të propozimit për bursat, pavarësisht se të gjitha grupet kanë vullnet ta mbështesin. Ai tha se nuk ka pasur asnjë dokumentacion të dorëzuar nga Kryetari ose Kuvendi për shqyrtim dhe kërkesa që përfituesit të jenë qytetarë të Prishtinës nuk ka marrë sqarim të qartë nga Ambasada Britanike sepse ekziston shqetësimi për precedentë të mëparshëm, ku mjete të dedikuara për subvencione janë bartur tek entitete të tjera (si në rastin e UNDP-së për 5 milionë euro), duke krijuar pyetje për ligjshmërinë e procesit, megjithëse vullneti për mbështetje ekziston, vendimi nuk mund të miratohet pa dokumentacion të plotë dhe pa njohuri të detajuara për procedurat e përdorimit të mjeteve publike.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë nga rendi i ditës dhe konstaton se më 26 vota për, 3 kundër edhe asnjë abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin e studentëve të programit të bursave në fushën e inteligjencës artificiale dhe Big Data, në vlerë prej dyzetmijë euro, (40.000).

Pika gjashtë

Miratimi i ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.

Shkëmb Manaj u shpreh se sot kemi sjell para jush për plotësim-ndryshim Rregulloren për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Prishtinës, me fokus në dy pika kryesore: Qiratë për qytetarët e zhvendosur, ku rregullorja aktuale parashikon subvencionim të qirave deri në pesë vjet dhe propozohet që kjo normë të lejojë zgjatje për raste të veçanta, si qytetarët e zhvendosur nga qendra e qytetit për ndërtimin e parkingut, derisa të gjendet një zgjidhje për banim të përhershëm dhe shpenzimet e funeralit, ku kërkohet rritja e shumës së subvencionit për anëtarët e ngushtë të

familjes nga 300 në 400 euro. Manaj theksoi se është i rëndësishëm diskutimi publik, duke përfshirë grupet parlamentare, OJQ-të dhe qytetarët, për të dhënë kontribut në përmirësimin e rregullores para miratimit final në Kuvend.

Gëzim Sveçla tha se qasja e kryesuesit për të hedhur çështjet në votim pa u diskutuar më parë, nuk është e drejtë dhe duhet të shmanget arbitrariteti. Përgjegjësia e kryesuesit si përfaqësues i Kuvendit, është që kërkesat e asamblistëve të trajtohen dhe t'u jepen përgjigje. Ai deklaroi se sa i përket çështjes së rregullores, është mirë që në fillim të rendit të ditës është ndryshuar, sepse nuk mundet me u bë ndryshimi i rregullores pa dalë në dëgjim publik.

Nora Kelmendi theksoi se projekt-rregullorja do të dalë në dëgjim publik, por do të përmendi disa nene, siç janë: neni 25, për subvencione për skema të veçanta, këtu duhet të përfshihet një nen që përcakton kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndarjen e subvencioneve, pasi kriteret aktuale nuk janë të qarta; neni 30, për subvencione me vendim të Kuvendit, ku ky nen është i jashtëligjshëm sipas raportimeve të auditorit (2022–2024), pasi nuk ka bazë ligjore për ndarje të subvencioneve mbi 20,000 euro me vendim të Kuvendit dhe nëse ekziston një bazë ligjore, duhet të sqarohet dhe publikohet. Nora rekomandon që të bëhet Publikimi i përshkrimeve të projekteve dhe arsyetimeve për subvencionim në faqen zyrtare të Komunës, krijimi i komisioneve monitoruese për ndjekjen e përfituesve të subvencioneve dhe granteve dhe caktimi i afateve për monitorimin e çdo aktiviteti të financuar. Ajo tha se këto masa synojnë krijimin e një mjedisi transparent dhe të drejtë, që nxit zhvillimin ekonomik dhe mundësi të barabarta për qytetarët e Prishtinës, dhe u kërkua që rekomandimet të merren parasysh.

Shkëmb Manaj deklaroi se rregullorja është miratuar pas diskutimeve në Kuvend dhe komentet e dhëna janë përfshirë, me mundësi që të shtohen edhe të tjera nëse diçka është lënë jashtë. Ai argumenton se neni 30 duhet të mbetet, pasi subvencionimi i ndërmarrjeve publike dhe i kopshteve me bazë në komunitet ka ndodhur vazhdimisht në Prishtinë, por pa një bazë të qartë ligjore. Manaj tha se kjo dispozitë krijon bazën ligjore për subvencione edhe për institucione të tjera komunale në të ardhmen, si institucionet kulturore. Sa i përket kopshteve me bazë në komunitet, ai pajtohet që në të ardhmen ato mund të planifikohen përmes buxhetit, pas një analize nga Drejtoria e Arsimit, ndërsa për ndërmarrjet publike, thekson se subvencionimi ndodh zakonisht në raste emergjente, të cilat nuk mund të parashikohen në buxhet. Ai propozon që për këtë vit të mbetet dispozita aktuale, ndërsa nga viti i ardhshëm të planifikohet më mirë në kuadër të buxhetit komunal.

Besart Krasniqi- tha se propozimi për rritjen e subvencionit për shpenzimet e varrimit në 400 euro, ka qenë fillimisht propozim i Lëvizjes Vetëvendosje, i cili ishte kundërshtuar më parë, por tani po mbështetet një vit më vonë. Ai shpreh kënaqësinë që ky propozim më në fund është marrë parasysh dhe konfirmon se grupi i Vetëvendosjes do ta mbështesë këtë rritje. Krasniqi rikujton një kërkesë të katër imamëve të Prishtinës, nga viti 2023, drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që hapja e varreve në fshatrat Bardhosh, Hajvali, Matiçan dhe Zllatar të kryhet nga ndërmarrja “Gjelbër” (ish-“Hortikultura”). Sipas tij, kjo kërkesë është bërë për shkak se kompanitë private aplikojnë çmime shumë më të larta, ndërsa shërbimi nga ndërmarrja publike do të ishte më i përballueshëm për qytetarët. Ai thekson se ende nuk ka pasur përgjigje nga drejtoria dhe kërkon që këtyre fshatrave t'u mundësohet kjo e drejtë, duke lehtësuar barrën financiare të familjeve në raste mortore.

Feim Osmani theksoi se rregullorja do të shqyrtohet në dëgjim publik dhe vërejtjet do të dorëzohen përsëri nga grupi i tyre. Osmani nënvizon dallimin mes ndërmarrjeve publike, që mund të gjenerojnë fitim, dhe kopshteve me bazë në komunitet, që janë OJQ dhe nuk krijojnë fitim, për këto të fundit përmend marrëveshjen e vitit 2016 me Komunën, e cila mund të rinovohet çdo vit për të siguruar subvencionimin e tyre.

Kryesusi konstatoi se më 31 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim miratohet Vendimi për vënien në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.

Pika e shtatë Pyetje dhe përgjigje

Besa Shahini- tha se është shqetësuese gjendja alarmante e mbeturinave në Prishtinë dhe kritikoi faktin që nuk u lejua diskutimi i kësaj teme si pikë e veçantë në rendin e ditës. Ajo parashtrori një pyetje konkrete: Pse kryetari i Komunës po refuzon të nënshkruajë një marrëveshje me kompaninë “Pastrimi” për menaxhimin ekskluziv të mbeturinave për 10 vitet e ardhshme, gjë që është kusht për realizimin e një investimi prej rreth 70 milionë eurosh nga BE-ja dhe Qeveria gjermane për përmirësimin e gjithë sistemit të menaxhimit të mbeturinave në kryeqytet? Ajo përmend si shembull të suksesshëm modelin e financimit të ndërmarrjes “Termokos”.

Nexhmije Gjema kritikoi mungesën e seriozitetit dhe komunikimin nga ekzekutivi, duke theksuar se kërkesat dhe email-et për informata shpesh mbeten pa përgjigje. Gjema ngre shqetësime për bllokimin e trotuareve në Lagjen e Muhaxhirëve, që rrezikon sigurinë e këmbësorëve dhe fëmijëve, Gjithashtu kërkon sqarime për memorandumun e 26 dhjetorit 2025, lidhur me menaxhimin e mbeturinave, për angazhimin e operatorëve privatë rreth 950 mijë euro ndërkohë që ndërmarrja “Pastrimi” është në krizë financiare, si dhe për anulimin e një tenderi prej 100 mijë eurosh për shërbimet e avokaturës, duke kërkuar transparencë dhe masa për të shmangur shkelje të ngjashme në të ardhmen.

Feim Osmani shpreh shqetësim për mungesën e kryetarit dhe drejtorëve në seancë, duke theksuar se pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve duhet të adresohen nga ekzekutivi. Ai ngre si problem kryesor situatën e rëndë me mbeturinat në fshatrat e Prishtinës, ku sipas tij ato mblidhen shumë rrallë, ndërsa qytetarët vazhdojnë të paguajnë shërbimin dhe kërkojnë masa urgjente, madje edhe pezullimin e pagesave derisa shërbimi të normalizohet. Osmani kërkojë sqarime për disa projekte të përcaktuara në buxhetin 2026, si furnizimi me ujë për Lagjen Kurti dhe fshatin Rimanishtë, rregullimi i një rruge në Vranidoll, si dhe informata për projektin dhe lejen e ndërtimit për shkollën në Besi, për të cilën Ministria ka premtuar financim prej disa vitesh.

Nora Kelmendi paraqiti dy shqetësime të qytetarëve. Së pari kërkojë sqarime nga Drejtoria e Arsimit se kur do të fillojë procesi mësimor në shkollën në Emshir, pasi objekti sipas banorëve tashmë është përfunduar dhe, së dyti, përcjell kërkesat e banorëve të lagjes “Hyzri Talla” në Bregun e Diellit, të cilët ankohen për mungesë investimesh, kanalizime të bllokuara që shkaktojnë përmytje gjatë reshjeve, shkallët në gjendje të keqe dhe mungesë të hapësirave të gjelbra dhe parkingut, duke kërkuar ndërhyrje nga Komuna.

Gëzim Sveçla falënderoi drejtorët që qëndruan deri në fund të seancës dhe theksoi rëndësinë e pikës “Pyetje–përgjigje” për adresimin e shqetësimeve të qytetarëve dhe për rritjen e performancës së ekzekutivit. Ai përgëzon emërimin e nënkryetarit dhe kërkoi që sa më shpejt të silllet në Kuvend rregullorja për “Prishtina Parking”, për të qartësuar situatën me gjobat pas vendimit të Gjykatës Supreme. Sveçla theksoi se Lëvizja Vetëvendosje do të mbështesë çdo vendim që i shërben qytetit, pavarësisht politikës, dhe bën thirrje që ekzekutivi të ndërmarrë hapa për zgjidhjen e problemit me mbeturinat dhe për funksionalizimin sa më të shpejtë të qeverisjes në interes të qytetarëve të Prishtinës.

Sokol Havolli u përgjigjet në disa çështje të ngritura nga kolegët e asamblesë, sa i përket fshatit Rimanishtë. Ai sqaroi se plani për furnizimin me ujë të pijshëm kërkon koordinim me kompaninë e ujësjellësit, por gjatë viteve të fundit janë bërë investime në rreth 32 km rrjet kanalizimi për mbrojtjen e ujërave natyrore për rrugën në Vranidoll, investimet më të vogla bëhen përmes kontratave zonale, ndërsa për rrjetin e kanalizimit janë krijuar kushtet për intervenim rrugor, për lagjen “Bregu i Diellit” dhe rr. “Hyzri Talla”. Janë bërë investime infrastrukturore, përfshirë riorganizimin e rrugës “Xheladin Rekalii” dhe hapësirat për parking, ndërsa mbetet nevoja për riorganizim të trotuareve dhe kontroll mbi parkingjet ilegale. Havolli theksoi se sa i përket rregullores së “Prishtina Parking”, punimet janë përfunduar sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme, dhe propozohet që në periudhë të shpejtë të sjellët plotësimi i rregullores për qartësi dhe zbatim të saktë.

Endrit Zabërgja falënderoi drejtorët dhe kolegët për durimin dhe bashkëpunimin gjatë seancës, duke uruar veçanërisht drejtorin Sokol Havolli, ai propozon që në të ardhmen pyetjet dhe përgjigjet nga qytetarët të trajtohen në fillim të seancave, për të rritur transparencën dhe për të lehtësuar punën e drejtorëve. Zabërgja nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit, pa marrë parasysh ndarjet politike dhe thekson nevojën për të diskutuar çështje praktike, si pastrimi, në një gjuhë të përbashkët për të ndihmuar qytetarët dhe për të marrë vendime të duhura.

Betim Abdullahu ngriti shqetësime për gjendjen kritike të fshatit Vranidoll, duke adresuar pyetje drejtuar Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Drejtorisë së Emergjencave: Rruga dhe kanalizimi janë në gjendje të mjerueshme, pusetat janë të thyera dhe fekale dhe ujërat atmosferikë dalin në oborret e banorëve, gropat e mëdha pengojnë qarkullimin e autobusëve, duke krijuar vështirësi për studentët dhe nxënësit. Abdullahu kërkon vendosje të shenjave sinjalizuese afër shkollës për sigurinë e fëmijëve, pasi rruga kryesore është e rrezikshme për shkak të trafikut dhe dëmtimeve të infrastrukturës. Ai shpreson që të merren masa urgjente për riparimin e rrugëve, kanalizimeve dhe sigurimin e qasjes së sigurt për banorët dhe nxënësit.

Feim Osmani theksoi urgjencën e ndërhyrjes në fshatin Vranidoll dhe rrethe, Rruga dhe kanalizimi janë në gjendje kritike, ujërat atmosferike dhe fekalet përfshijnë shtëpitë për shkak të mungesës së gropave septike dhe kanalizimeve jo funksional që nga viti 2008. Osmani tha se problemet ekzistojnë edhe në fshatrat Rimanishtë dhe Besi, ku ujërat e zeza grumbullohen në hapësira të hapura, duke rrezikuar ambientin dhe duke kundërmuar aromë të padurueshme në stinën e verës. Ai kërkoi veprime urgjente për riparimin e rrugëve dhe kanalizimeve për të mbrojtur banorët dhe ambientin.

Sokol Havolli u shprehu i gatshëm për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me ekipet teknike për intervenime emergjente dhe mbrojtjen e infrastrukturës, duke përfshirë, trajtimin me prioritet të ujërave të zeza jashtë rrjetit të dedikuar, intervenime në hapësirat që janë kompetencë e Komunës, duke ndihmuar edhe në ato që varen nga niveli qendror (Ministria e Infrastrukturës), për të mbrojtur pasurinë dhe sigurinë e qytetarëve. Havolli vlerësoi nevojën për inspektim të terrenit me kolegët e asamblesë, për të adresuar problemet specifike në mënyrë praktike.

Lulzim Fushtica dha përgjigje për dy çështjet kryesore: Siguria te shkolla në Vranidollë është bërë vlerësimi i rrezikshmërisë për 66 shkolla të kryeqytetit, përfshirë shkollën në Vranidoll dhe rekomandimet për masat e sigurisë do të implementohen së shpejti në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Arsimit. Fushtica tha se sa i përket Vërshimeve dhe mungesës së kanalizimit në Vranidoll, janë regjistruar dëme nga vërshimet e janarit, është përgatitur raport dhe rekomandim për ndërhyrje, dhe është themeluar komisioni për vlerësimin e dëmeve dhe kërkesat për dëmshpërblim do t'i dërgohen qeverisë sipas Rregullores së vitit 2022.

Shkëmb Manaj thekson se përgjigjet e disa drejtorëve munguan, veçanërisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit, dhe kërkoi që në seancat e ardhshme të qëndrojnë deri në fund për t'iu dhënë qytetarëve informacion të plotë, për çështjen e pastrimit, sugjeron një seancë të veçantë për të diskutuar menaxhimin e mbeturinave. Manaj u shpreh se drejtorët dhe zyrtarët e Komunës janë të obliguar të përgjigjen brenda afateve ligjore për çdo pyetje të Kuvendit, nëse nuk e bëjnë, anëtarët duhet të njoftojnë Kuvendin. Ai shprehu mendimin se seanca ishte e frytshme, pasi janë diskutuar pika me rëndësi për kryeqytetin dhe qytetarët e Prishtinës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:53

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të nenit 51, paragrafi 51.1, të nenit 53, paragrafi 53.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të neneve 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit administrativ, nr. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d**, të nenit 44, paragrafi 44.1, pika **b** dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, të nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110 - 273423, të dt. 09.12.2014, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më2026, miratoi këtë

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

I.

Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për komunitete, si komitet i përhershëm.

II.

Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. , përfaqësues i shumicës;
2. , përfaqësues i shumicës;
3. , përfaqësues i shumicës;
4. , përfaqësues i komunitetit serb;
5. , përfaqësues i komunitetit turk;
6. , përfaqësues i komunitetit boshnjak;
7. , përfaqësues i komunitetit ashkali;
8. , përfaqësues i komunitetit rom dhe
9. , përfaqësues i komunitetit goran.

III.

Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për promovimin dhe afirmimin e të drejtave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkëlqje që bëhet në këtë drejtim, bën rekomandime në Kuvendin e Komunës, shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës, si dhe ushtron edhe

përgjegjësi të tjera, nëse nuk është rregulluar ndryshe me LVL-në dhe me Statutin e Komunës.

IV.

Anëtarëve të cekur në pikën II të këtij vendimi, do t'u takojë kompensimi për punën e tyre në pajtim me Udhëzimin administrativë nr. 08/2008, për pagesën e stafit politik në komuna.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 51, paragrafi 51.1 i LVL-së, është i obliguar të formojë Komitetin për komunitete, si komitet i përhershëm.

Sipas **Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110- 273423, të dt. 09.12.2014**, Komiteti për komunitete nga nëntë (9) anëtarë që duhet të ketë në përbërje:

- një (1) nga komuniteti rom, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti turk, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti ashkali, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti boshnjak, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- dy (2) nga komuniteti serb, njëri duhet të jetë anëtar i Kuvendit;
- tre (3) nga përfaqësuesit e shumicës, shqiptarë, së paku njëri prej tyre duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Për të theksuarën, ky propozimvendim për formimin e Komitetit për komunitete i dërgohet në kompetencë të mëtejme Komitetit për Politike dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**) e Ligjit nr. 03/L – 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më . . 2026, merr këtë

VENDIM
PËR EMËRIMIN E DELEGATËVE PËR KOLEGJIUMIN E ASOCIACIONIT TË
KOMUNAVE TË KOSOVËS (AKK)

1. Miratohet emërimi i delegatëve për kolegjiumin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), me këtë përbërje:

1. , anëtar,
2. , anëtar,
3. , anëtar,
4. , anëtar,
5. , anëtar.

2. Emërimi i delegatëve për kolegjiumin e Asociacionit të Komunave të Kosovës ka qëllim për të siguruar përfaqësim të rregullt dhe transparent të komunave në organet e AKK-së.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE NË KOMUNËN
E PRISHTINËS, 2026-2028

Neni 1

Miratohet Vendimi i Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2026-2028.

Neni 2

Qëllimet kryesore të Planit të veprimit për shërbime sociale janë: shërbime sociale të integruara për grupet e cenuara, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara (të mitur dhe të rritur), zhvillimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, të këshillimit dhe digjitalizimi i bazës së të dhënave dhe mbështetje për strehim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale.

Neni 3

Përfitues të këtij Plani të Veprimit janë fëmijët, të moshuarit, fëmijët, të rinjtë në konflikt me ligjin, ata që konsumojnë dhe përdorin alkool dhe droga të tjera, personat me sëmundje kronike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të rinjtë me vështirësi në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor, dhe ata që janë në rrezik abuzimi dhe/ose neglizhimi që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe dhuna në familje.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2026-2028.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**Plani i veprimit për shërbime sociale në kryeqytet
2026 – 2028**

Prishtinë
2025

Tabela e shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
COFOG	Classification of the functions of government Klasifikimi i funksioneve të qeverisë
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DPMS	Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
KOMF	Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
LNOB	Leave No One Behind
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPFVLÇ	Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
OJQ	Organizata joqeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SOS	SOS Fshatrat e Kosovës
TdH	Terre des Hommes
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UA	Udhëzim administrativ

Dokumentet e Referimit

- Analizë e Qendrave për Punë Sociale 2022¹;
- Analizë e Situatës, Save the Children, Euro Center for Social Research, 2018;
- Buxheti i miratuar i Komunës së Prishtinës 2025²;
- Ligji i Buxhetit 2026³;
- Manuali për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike, ZKM, 2019;⁴
- Profili i Komunave të Kosovës, MAPL;
- Raporti i DMS, Komuna e Prishtinës 2020⁵;
- Raporti i Institutit GAP/Letërnjoftimi i Komunës së Prishtinës⁶;
- Rregullore Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve⁷;
- Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Komuna e Prishtinës⁸;
- Rregullore për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës⁹;
- Statistikat Sociale 2020, MPMS, ASK, 2021;
- Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030¹⁰;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, ZKM, 2016¹¹;
- Strategjia Sektoriale e MPMS 2018-2022, MPMS, 2018¹².

¹ <https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2023/11/Analiza-shqip-1.pdf>

² <https://prishtinaonline.com/investimet/buxheti>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>

⁴ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/manual-per-planifikimin-hartimin-dhe-monitorimin-e-dokumenteve-strategjike-dhe-planeve-te-tyre-te-veprimit.pdf>

⁵ <https://prishtinaonline.com/raportet-e-punes-se-drejtoreve>

⁶ <https://komunat.institutigap.org/reports>

⁷ https://prishtinaonline.com/uploads/draft_rregullorja.pdf

⁸ https://prishtinaonline.com/uploads/6_1_projektregullorja_per_subvencione_1.pdf

⁹ https://prishtinaonline.com/uploads/propozim_rregullorja-per-te-hyrat-vetanake-te-institucioneve-kulturore_diskutim_publik.pdf

¹⁰ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

¹¹ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/06/Strategjia_Komb%C3%ABtare_p%C3%ABr_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

¹² <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-e-ministrise-se-punes-dhe-mireqenies-sociale-2018-2022/>

Përmbledhje ekzekutive

Në të gjitha shoqëritë ka njerëz që kanë vështirësi të kujdesen për veten dhe familjen e tyre, dhe për këtë arsye kanë nevojë për kujdes dhe mbështetje nga të tjerët. Shembujt më të dukshëm janë fëmijët në nevojë, të moshuarit, të varfëritë, mirëpo edhe shumë të rritur, të mirëedukuar e të pasur mund ta gjejnë veten në këtë pozicion.

Në disa situata, ndërhyrjet e mbështetjet nga familjet e tyre, dhe nganjëherë nga miqtë dhe fqinjët janë të mjaftueshme. Shpeshherë këto ndërhyrje nuk mjaftojnë, dhe në shumë situata njerëzve ju duhet të kërkojnë ndërhyrje jashtë familjes së tyre siç janë institucionet qeveritare të mandatuara ose shërbimeve të ofruara përmes organizatave joqeveritare (OJQ).

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria për Mirëqenie Sociale së bashku me OJQ “SOS Fshatrat e Fëmijëve”, Qendrën për Punë Sociale (QPS), si institucioni primar për ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe institucionet dhe organizatat tjera joqeveritare/OJQ-të, bazuar në nevojën për të planifikuar në mënyrë sa më efikase ofrimin e shërbimeve sociale, për tri vitet në vijim, 2026–2028, kanë themeluar grupin punues për hartimin e një plani të veprimit për këto shërbime në Komunën e Prishtinës.

Ky plan i veprimit është hartuar bazuar në hulumtimin e gjendjes në terren, analizës së raporteve që trajtojnë mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale në Komunën e Prishtinës dhe kontributit të stafit nga QPS-ja në Prishtinë dhe stafit nga OJQ të ndryshme në Komunën e Prishtinës. Një mbështetje e pamohueshme në këtë proces është ofruar edhe nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, përkatësisht Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare/DPSF dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.

Hartimi i këtij plani të veprimit dhe temat e përfshira në këtë plan të veprimit janë diskutuar gjatë punëtorive të organizuara me qëllim të hartimit të këtij plani dhe komunikimit të rregullt që është zhvilluar gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti. Procesi i hartimit të këtij plani është përkrahur nga një konsulent i angazhuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.

Plani Lokal i Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës 2026–2028 që është në linjë me objektivat e Strategjisë Sektoriale 2018-2022 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ekipi i Hartimit të këtij Plani të veprimit ka vendosur që në kuadër të këtij plani të përfshihen dhe harmonizohen katër objektiva të ndërlidhura me ato të strategjisë dhe planit të veprimit të nivelit qendror për mirëqenien sociale që përfshijnë këto fusha:

1. Shërbime sociale të integruara për grupet e cenuara.
2. Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara.
3. Zhvillimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, telekëshillimi dhe digjitalizimi i bazës së të dhënave.

4. Mbështetje për strehim, rehabilitim, riintegrim dhe risocializim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale.

Në pjesën e parë, grupi punues ka përcaktuar principin e punës për zhvillimin e planit, dokumentet dhe të dhënat bazë që do të përdoren për këtë plan, prioritetet dhe grupet më të cenuara në Komunën e Prishtinës dhe në bazë të këtyre janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet, rezultatet e pritshme, indikatorët/treguesit e ndryshimit të synuar, buxheti për secilin objektiv dhe aktivitetet, akterët dhe institucionet e OJQ-të përgjegjëse, hisedarët dhe implementuesit.

Ky plan veprimi mbulon periudhën 2026–2028 dhe do të zbatohet në përputhje me planin e aktiviteteve të parashikuara. Zbatimi i tij do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me akterët lokalë në nivel komunal, si dhe me institucionet përkatëse dhe organizatat joqeveritare në nivel qendror të Republikës së Kosovës.

Përfitues të këtij Plani të veprimit, janë fëmijët, të moshuarit, të rinjtë në konflikt me ligjin, ata që konsumojnë dhe përdorin alkool dhe droga tjera, personat me sëmundje kronike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të rinjtë me vështirësi në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor, dhe ata që janë në rrezik abuzimi dhe/ose neglizhimi që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe dhuna në familje.

Hyrje

Komuna e Prishtinës - Demografia

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht qyteti i saj më i madh si për nga sipërfaqja ashtu edhe për nga popullsia. Ajo është po ashtu qendra kryesore ekonomike, politike, financiare dhe tregtare e Kosovës dhe gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Shumicën dërmuese të popullsisë e përbëjnë shqiptarët, por aty jetojnë edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike si rom, boshnjak, serb, etj.

Komuna e Prishtinës ka 572 km².

Prishtina gjendet në pjesën veriperëndimore dhe shtrihet buzë rrafshnaltës së pëlleshme rrzë maleve të argjendta. Ashtu si dikur Ulpiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimet parësore kontinentale. Komuna e Prishtinës i ka gjithsej 48 fshatra¹³.

Komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës janë: serb, turk, boshnjak, rom, ashkali etj. Sektori i bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë përshin 27 biznese. Në sektorin e industrisë nxjerrëse ekzistojnë 16 biznese. Sektori i furnizimit me energji elektrike, gas dhe ujë numëron 5 biznese, ai i ndërtimitarisë me 329 biznese, ndërsa ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë 4.203 biznese. Po ashtu edhe biznesi i hotelarisë po avancohet përditë e më shumë dhe kështu në Komunën e Prishtinës aktualisht ekzistojnë 781 restorante dhe hotele. Në biznesin e ndërmjetësimit financiar, veprimtarinë e tyre e zhvillojnë 26 biznese, ndërsa në shërbimin e afarizmit ekzistojnë 273 biznese. Administrimi publik dhe mbrojtja e sigurimit social vepron me 10 biznese, ndërsa mbrojtja shëndetësore e sociale me 104 veprimtari. Numri i përgjithshëm i biznesit në Komunën e Prishtinës është 8.412 sish. Në Komunën e Prishtinës ekzistojnë edhe 57 prona shoqërore me 143 biznese shoqërore. Kështu, numri i përgjithshëm i biznesit të regjistruar në Komunën e Prishtinës është 8.735 biznese më 75.089 punëtorë.

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, Prishtina ka 227,466¹⁴ banorë. Femra janë 114 882, meshkuj 112 584. Popullsia e Prishtinës ka shënuar rritje prej 9 % që nga regjistrimi i popullsisë më 2011. Prishtina është një ndër komunat me densitet mesatarisht të lartë të popullsisë (rreth 385 banorë për kilometër katrorë). Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Prishtinës shpenzohet për paga dhe mëditje (35%). 22% e buxhetit ndahet për investime kapitale. Kjo shënon rënie të madhe nga vitet e mëhershme kur për investime kapitale është ndarë 51 % e buxhetit total.

Mëse 1.3 % e banorëve të Prishtinës janë në skemën e ndihmës sociale. Numri i nxënësve në Komunën e Prishtinës ka shkuar duke rënë, por kjo rënie (-13%) është relativisht e ulët në krahasim me komunat tjera.

¹³ <https://prishtina.rks-gov.net/historiku/>

¹⁴ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Census%20population__6_Sipas%20vendbanimeve__19%20Popullsia%20e%20komun%3%abs%20s%3%ab%20Prishtin%3%abs%20sipas%20vendbanimit/PopSex19.px/table/tableViewLayout1/

Në Komunën e Prishtinës janë aktive mbi 31,000 biznese. Në sektorin privat në Komunën e Prishtinës janë të punësuar 205 mijë persona, kurse në sektorin publik (pa llogaritur nivelin qendror) 4.600 persona.

Bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, në vitin 2024, Prishtina kishte 227,466 banorë.

Popullsia e Komunës së Prishtinës – Regjistrimi 2024¹⁵

Komuniteti / Gjinia	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shqiptarë	112,584	114,882	227,466
Serbë	770	—	770
Boshnjakë	356	—	356
Turq	2,138	—	2,138
Romë	57	—	57
Ashkali	427	—	427
Balkan Eryptians (Egyptianë)	17	—	17
Goranë	188	—	188
Tjerë	515	—	515
Gjithsej	—	—	231 934

Institucionet kryesore të shtetit, Presidenca, Qeveria, Kuvendi, ministritë, Banka Qendrore, etj., edhe fizikisht edhe administrativisht gjenden në Prishtinë, gjë që e bën Prishtinën të jetë më e populluar dhe të ketë mbingarkesë në aspektin e ofrimit të shërbimeve, në të gjitha fushat. Buxheti, për Komunën e Prishtinës për vitin 2026 është i planifikuar në rreth 151 milionë euro¹⁶.

Ekonomia

Në korrik të vitit 2021 në Komunën e Prishtinës ishin aktive 30,761 biznese. Përkundër pandemisë, numri i bizneseve në këtë komunë ka shkuar duke u rritur. Në sektorin privat në Komunën e Prishtinës janë të punësuar rreth 206,000 persona. Kjo tregon se bizneset që funksionojnë në Komunën e Prishtinës kryesisht janë biznese të mesme, që punësojnë një deri shtatë persona. Përveç, 206,000 të punësuarve në sektorin privat në territorin e Komunës së Prishtinës, në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar edhe 4,605 persona. Në anën tjetër, numri i kontributpaguesve aktiv nga Prishtina në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust) është dukshëm më i vogël sesa numri i të punësuarve. Kjo tregon që në Prishtinë punojnë shumë qytetarë të komunave tjera, për shkak se Prishtina është edhe selia e institucioneve qendrore qeverisëse.

¹⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹⁶ Buxheti i Republikës së Kosovës 2025

Mirëqenia Sociale

Komuna e Prishtinës është ndër komunat që e ka ndarë Drejtorinë e Mirëqenies Sociale nga ajo e Shëndetësisë. Skema e ndihmës sociale në qershor të vitit 2025 ishin 790 familje me rreth 3 000 anëtarë të familjeve nga Prishtina në skemën e ndihmës sociale.

Sipas raportit të QPS, Prishtinë për vitin 2024, në këtë institucion që ka tri njësi, janë ofruar 64 shërbime të ndryshme, për 49 kategori grupesh të cenushme, për gjithsej 23 088 shërbime sociale dhe 1415 shërbime administrative.

Për mirëqenien sociale në Komunën e Prishtinës institucionet primare janë:

1. Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
2. Qendra për Punë Sociale.
3. Shtëpia për të moshuarit pa përkujdesje familjare.

Ndërsa, Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucioni kryesor për ofrimin e shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, si kryeqytet Prishtina ka edhe një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime për kategori të ndryshme të personave dhe komuniteteve në nevojë. Me theks të veçantë duhet të përmenden strehimoret për viktimat e dhunës në familje, dhe viktimave të trafikimit me qëndrim rezidencial, si dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Metodologjia

Hartimi i Planit të veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës është zhvilluar në përgjigje të nevojës për të forcuar sistemin lokal të mirëqenies sociale dhe për të garantuar mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Procesi është udhëhequr nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (Departamenti për Politika Sociale dhe Familje), si dhe me mbështetjen e një konsulentit të jashtëm nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë.

Ky dokument është ndërtuar mbi bazën e Kornizës së Planifikimit Strategjik të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit administrativ. Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Ky udhëzim siguron një qasje të unifikuar institucionale dhe procedural për zhvillimin e politikave publike, duke promovuar gjithë përfshirje, koordinim ndërsektorial dhe orientim drejt rezultateve.

Metodologjia e ndjekur ka qenë gjithëpërfshirëse dhe e ndërtuar mbi katër shtylla kryesore:

1. **Kërkimi dhe analiza legislative dhe politike** – janë shqyrtuar aktet ligjore dhe nënligjore relevante, si dhe dokumentet strategjike ekzistuese në fushën e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të grupeve të marginalizuara.
2. **Konsultimi institucional dhe ndërsektorial** – janë zhvilluar takime të rregullta me grupin punues ndërinstitucional, i cili përbëhet nga përfaqësues të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë Komunën e Prishtinës, Qendrën për Punë Sociale, organizata joqeveritare dhe partnerë ndërkombëtarë.
3. **Angazhimi i drejtpërdrejtë i shoqërisë civile dhe komunitetit** – janë organizuar punëtori dhe tryeza të hapura me aktorë nga fusha e shërbimeve sociale, përfaqësues të komuniteteve të cenueshme, si dhe organizata të specializuara në mbrojtjen e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera në rrezik social.
4. **Pjesëmarrja aktive e palëve të interesit** – procesi është ndërtuar mbi parimin e bashkëpunimit dhe bashkë krijimit. Përfaqësues nga KOMF, SOS Fshatrat e Fëmijëve, HANDIKOS, OFAP, Terre des Hommes në Kosovë, YMCA Kosovo, MVPT, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizata të tjera kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në përkufizimin e prioritetëve dhe masave të ndërhyrjes.

Kjo qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse ka siguruar që Plani i veprimit të jetë jo vetëm dokument strategjik, por edhe reflektim i nevojave reale në terren, duke garantuar që politikat e miratuara të jenë sociale në përmbajtje, të zbatueshme në praktikë dhe të ndjeshme ndaj dinamikave të komunitetit.

Konteksti Strategjik

Plani i Veprimit për Shërbime më të mira Sociale në Komunën e Prishtinës është konceptuar si një zgjatim operacional i objektivave të legjislacioni primar dhe sekondar, i zhvilluar në përputhje me realitetin social dhe institucional të kryeqytetit. Ky plan merr parasysh sfidat në rritje që ka para vetes Komuna e Prishtinës, si pasojë e dinamikës demografike, migrimit të brendshëm, emigrimit të vazhdueshëm të të rinjve, si dhe shtimit të rasteve sociale dhe dukurive të ndërlydhura me to, përfshirë varfërinë, dhunën në familje, abuzimin me substanca dhe përjashtimin social.

Në dy dekadat e fundit, Prishtina ka përjetuar një rritje të shpejtë të popullsisë, për shkak të migrimit të brendshëm nga komunat e tjera të Kosovës, çka ka rezultuar në rritje të kërkesave për shërbime publike dhe, në veçanti, për shërbime sociale. Kjo rritje, e kombinuar me tendencën në rritje të emigrimit të të rinjve dhe familjeve të tëra në vendet perëndimore, ka krijuar një boshllëk në fuqinë punëtore dhe një presion shtesë mbi mekanizmat ekzistues të mbështetjes sociale.

Për më tepër, kapacitetet institucionale për përballje me këto sfida kanë mbetur të kufizuara. Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, si institucioni kryesor për zbatimin e politikave të mirëqenies sociale në nivel lokal, vazhdon të përballlet me mungesë të stafit profesional, mbingarkesë me raste dhe resurse të pamjaftueshme për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe cilësore.

Si pjesë e përgjigjes ndaj këtyre zhvillimeve, ky Plan Veprimi synon jo vetëm adresimin e sfidave ekzistuese, por edhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme në fushën e shërbimeve sociale. Kjo përfshin forcimin e rolit të Qendrës për Punë Sociale, ngritjen profesionale të punonjësve socialë, si dhe përfshirjen aktive të organizatave të shoqërisë civile dhe ofruesve të tjerë të licencuar të shërbimeve në nivel komunitar.

Konteksti Ligjor

Sistemi i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Republikën e Kosovës bazohet në një kornizë të gjerë ligjore, e cila është ndërtuar gradualisht në dy dekadat e fundit në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat sociale. Ky sistem synon të garantojë qasjen e qytetarëve në shërbime sociale cilësore, të përcaktojë përgjegjësitë institucionale dhe të promovojë mbrojtjen e grupeve të cenueshme.

Ligjet dhe aktet nënligjore mbulojnë një spektër të gjerë të fushave – nga mbrojtja e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit me qenie njerëzore, deri te të drejtat e azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe të huajve. Po ashtu, korniza ligjore rregullon çështje të drejtësisë për të mitur, shëndetit mendor, statusit dhe përkujdesjes për persona paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe udhëzimet administrative dhe rregulloret e Qeverisë, të cilat detajojnë procedurat për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve, funksionimin e qendrave për mbrojtje dhe rehabilitim, si dhe standardet për strehim e përkujdesje.

Kjo kornizë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis Communautaire të BE-së dhe pasqyron parimet e Kartës Sociale Evropiane dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Ajo ofron bazën juridike për funksionimin e shërbimeve sociale edhe në nivel lokal, përmes marrëveshjeve ndër-institucionale që përcaktojnë rolin e komunave, përfshirë Komunën e Prishtinës, në zbatimin praktik të tyre.

Megjithëse legjislativi është gjithëpërfshirës, sfida kryesore mbetet implementimi. Mungesa e burimeve financiare, kapaciteteve profesionale dhe mekanizmeve të fortë të monitorimit pengon zbatimin efektiv të ligjeve. Kjo situatë nënvizon nevojën për forcimin e institucioneve, përmirësimin e koordinimit ndër sektorial dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për të drejtat sociale. Në këtë kuptim, Komuna e Prishtinës ka mundësi të zhvillojë plane veprimi më konkrete e të integruara, duke u mbështetur në këtë bazë ligjore për të ofruar shërbime sociale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët e saj.

Analiza e gjendjes në nivel vendi

Në nivel vendi, sistemi i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Republikën e Kosovës vazhdon të përballet me sfida të thella dhe të vazhdueshme që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve, veçanërisht të atyre që i përkasin grupeve më të cenueshme, si familjet në varfëri, fëmijët pa përkujdesje prindërore, gratë viktimat të dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet në rrezik social.

Rezoluta e Parlamentit Evropian B7-0004/2014 për procesin e integritimit të Kosovës në BE ka theksuar shqetësime të thella në lidhje me përhapjen e varfërisë, mbulimin e kufizuar të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe varësinë e lartë nga shpenzimet vetjake për kujdes shëndetësor. Raporti bën thirrje për rishikim të politikave të ndihmës sociale, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve dhe grupeve të tjera të marginalizuara, përmes krijimit të skemave të posaçme mbështetëse.

Në Kosovë, përgjegjësia për politikë bëjnë dhe ofrim të shërbimeve sociale është e ndarë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës

Çlirimtare (MPFVLÇ) përmes Departamentit për Politika Sociale dhe Familje ka pasur historikisht rolin udhëheqës në zhvillimin e politikave të mbrojtjes sociale dhe mbikëqyrjen e sistemit. Kjo ministri ka marrë përgjegjësinë për **institucionalizimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve sociale profesionale**, përfshirë strehimoret, qendrat për viktimat e trafikimit dhe institucionet për mbrojtjen e fëmijëve në situata të rrezikut.

Ky zhvillim ka për qëllim të rrisë **llogaridhënien, profesionalizmin dhe sigurinë ligjore** të shërbimeve të specializuara në mbrojtjen sociale dhe penale, si dhe të sigurojë koordinim më të mirë ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe atij social në trajtimin e rasteve të ndjeshme.

Nga ana tjetër, në nivel lokal, ofrimi i shërbimeve sociale vazhdon të jetë përgjegjësi e komunave, përmes **Drejtorive Komunale për Mirëqenie Sociale dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS)**, bazuar në **Memorandumin e Mirëkuptimit të vitit 2009** ndërmjet MAPL, MF dhe MPMS. QPS-të mbajnë një rol qendror në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rasteve sociale dhe familjare në komunitet.

Megjithëse decentralizimi i shërbimeve synonte të përmirësonte qasjen dhe efikasitetin, përvoja në praktikë tregon se komunat nuk janë pajisur me burime të mjaftueshme, qoftë financiare, profesionale apo infrastrukturore, për të realizuar mandatin e tyre në mënyrë të plotë. Kjo ka çuar në mbingarkesë të QPS-ve, mungesë të punonjësve socialë të kualifikuar, ndërprerje të shërbimeve në raste kritike dhe rrezik për cenimin e të drejtave të përfituesve.

Për më tepër, dukuritë sociale negative si emigrimi masiv i të rinjve, rritja e dhunës në familje, abuzimi me substanca dhe marginalizimi i fëmijëve dhe të moshuarve pa përkujdesje adekuate e thellojnë nevojën për një **qasje sociale të koordinuar dhe të shumëfishtë**. Kjo kërkon jo vetëm forcim të kuadrit institucional dhe ligjor, por edhe ndërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve humane dhe profesionale në çdo nivel të ofrimit të shërbimeve.

Në këtë kontekst, rritja e bashkëpunimit ndërinstucional, veçanërisht ndërmjet MPFVLÇ, Ministrisë së Drejtësisë, MAPL, MF, komunave dhe organizatave të shoqërisë civile, është kyçe për të krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe të drejtë të mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës.

Papunësia

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë e ndërthurur e papunësisë së lartë, aktivitetit të ulët ekonomik dhe pabarazive të theksuara gjinore – që reflektohen edhe në nivelin lokal, duke përfshirë Komunën e Prishtinës.

Sipas të dhënave të fundit (TM4 2024) nga ASK, në:

- 12,9% – ishte shkalla e papunësisë së përgjithshme (për të gjithë popullsinë 15+), duke u rritur me 0.2 pikë përqindjeje krahasuar me TM4 2023¹⁷.
- 7,7% – shkalla e papunësisë për meshkujt dhe 17,6% për femrat, duke nxjerrë në pah një pabarazi konkurrimi gjinor.

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës

- 18,4% – ishte shkalla e papunësisë të të rinjtë (15–24 vjeç), një ulje modeste nga 16.7% në vitin paraprak, por që vazhdon të mbetet në nivele të larta.
- 38,8% – ishte shkalla e punësimit (15–64 vjeç) dhe 56,4% fuqia joaktive, tregues ky i uljes së pjesëmarrjes aktive në tregun e punës.

Planifikimet kryesore:

- Papunësia vazhdon të mos zbrësë nën nivelin 10%, me një tendencë të luhatjes së lehtë në tremujorin e fundit.
- Pabarazitë gjinore janë të ndjeshme: dyfish më shumë femra të papuna sesa meshkuj (17.6% vs. 7.7%).
- Të rinjtë mbeten grup me më shumë rrezik, 1 në 5 është i papunë.
- Fuqia punëtore është ende e kufizuar: më shumë se gjysma e moshës së punës është joaktive.

Në kontekstin e Prishtinës, si kryeqendër që përqendron popullsi nga e gjithë Kosova, këto fenomene mund të jenë edhe më të theksuara për shkak të urbanizimit, emigrimit të të rinjve dhe mungesës së mundësive për punësim formal.

Shqetësimi social kryesor është se përtej papunësisë, rritet edhe fenomeni i të rinjve që nuk punojnë, nuk studiojnë e as nuk trajnohen (NEET), potencialisht duke krijuar një brezi me perspektiva të kufizuara dhe pasiguri ekonomike në të ardhmen. Gjithashtu, pabarazitë gjinore theksojnë nevojën për politika aktive për punësim dhe barazi në tregun e punës.

Ndihmat sociale

Skema e Ndhmës Sociale është mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet që jetojnë në varfëri. Kjo skemë rregullohet me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe me Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Paga mujore e përfituesve të kësaj skeme bëhet sipas numrit të anëtarëve të familjes. Shuma minimale është 70 euro për familjet me një 1 anëtar, ndërsa shuma maksimale është 250 euro për familjet me 15 anëtarë. Për çdo fëmijë të moshës 0-16 vjeçar shpërndahen edhe shtesat për fëmijë, 30 euro për fëmijët deri 2 vjeç dhe 20 euro për fëmijët deri në moshën 16 vjet, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit. Numri total i qytetarëve në SNS në Komunën e Prishtinës për vitin 2025 ishte rreth 3000 anëtarë. Numri i familjeve përfituese nga skema e ndihmës sociale, secilin vit shënon një rënie të lehtë.

Bazuar në të dhënat zyrtare, rreth 1.3 % e popullatës së përgjithshme të Prishtinës janë pjesë e skemës së ndihmës sociale.

Shërbimet sociale

Me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 08/l-255, është e përcaktuar dhe rregulluar një listë e personave në nevojë për mbrojtje sociale dhe përfshin fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me sjellje asociale, delikente të mitur, marrëdhëniet e çrregulluara familjare, sëmundje

trupore ose aftësi të kufizuar fizike, aftësi të kufizuar mendore, sëmundje mendore, rrezik nga shfrytëzimi apo abuzimi, dhuna në familje, trafikimi njerëzor, varësi nga alkooli ose droga, fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara ose emergjencat, apo shkaqe tjera që i bëjnë personat nevojtarë. Ky ligj përcakton dhe rregullon edhe rolin dhe përgjegjësitë e MPFVLÇ, komunës, QPS, Sektorit joqeveritar dhe Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Komponentët kryesorë të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal përfshijnë Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrat për Punë Sociale (QPS), institucionet rezidenciale, si dhe rrjetin e OJQ-ve të zhvilluara për të mbështetur grupet e cenueshme.

Komuna e Prishtinës që nga viti 2021 e ka ndarë Drejtorinë për Mirëqenie Sociale (DMS) nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS). Sipas organogramit të Komunës së Prishtinës QPS-ja është renditur nën përgjegjësinë e Drejtoratit Komunal për Mirëqenie Sociale (DMS).

Buxheti i planifikuar i Komunës së Prishtinës sipas kategorive ekonomike: 36 % të buxhetit të përgjithshëm shpenzohet për paga dhe mëditje; 23 % mallra dhe shërbime; 2% shpenzime komunale; 5% subvencione; 31 % shpenzime kapitale dhe 3 % rezerva.

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Prishtinës ndanë më së paku buxhet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, çfarë mundëson që buxheti të orientohet më shumë për investime.

Infrastruktura

Për ofrimin e shërbimeve sociale ekziston një rrjetë kombëtare e Qendrave për Punë Sociale (QPS), me pajisje fizike të dedikuara dhe staf me përvojë. Kjo paraqet një platformë të fortë mbi të cilën mund të tutje të zhvillohet dhe ndërtohet infrastruktura e ardhshme për shërbime sociale. Kjo është një përparësi pozitive për ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të mira sociale në vend.

Gjithsej 38 QPS-të e shpërndara nëpër 38 komunat e Kosovës sigurojnë mbulimin gjeografik të tërë vendit. Edhe Komuna e Prishtinës ka QPS-në (me 3 njësi funksionale) që mbulon tërë territorin e komunës. QPS-të përveç tjerave, bëjnë vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve pas pranimit të kërkesës për asistencë apo shërbim social.

QPS është e pajisur me inventar të zyrës, pajisje kompjuterike dhe automjete për kryerjen e punëve ditore dhe shërbimeve sociale. Mirëpo me ngritjen e problemeve sociale dhe nevojës për trajtimin e çdoherë më shumë rasteve sociale, këto burime në dispozicion nuk janë të mjaftueshme dhe ka shumë disproporcion të numrit të profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në krahasim me numrin e klientëve dhe kërkesave për shërbime, dhe e njëjta vlen edhe për numrin e automjeteve në dispozicion të QPS në Prishtinë. Andaj, në të ardhmen do të duhet siguruar financim më i qëndrueshëm dhe përmirësim i kësaj infrastrukture dhe mirëmbajtja e saj, në mënyrë që QPS të mund t'u përgjigjet kërkesave të qytetarëve në nevojë.

Komuna e Prishtinës tani ka filluar ndërtimin e objekti të ri të Qendrës për Punë Sociale, ku planifikohet të fuzionohen tri njësitë aktuale.

Buxheti

Ligji për Financimin e Pushtetit Lokal siguron një alokim të bazuar në formulë të transfereve qendrore për të siguruar parashikueshmërinë e të ardhurave komunale, si dhe një masë barazimi mes komunave. Ky ligj i ndan transferimet në komuna në tri grante kryesore:

- një grant i përgjithshëm;
- një grant specifik për arsimin dhe
- një grant specifik për shëndetësinë.

Nga kjo ndarje buxhetore po ashtu mund të konstatohet se mënyra e përgatitjes së buxhetit bëhet ende në mënyre historike dhe jo e bazuar në nevojat reale.

Burimet njerëzore

Në tërë territorin e Kosovës, QPS-të punësojnë një numër prej 411 punëtorëve. Në QPS Prishtinë janë të punësuar 18 zyrtarë të shërbimeve sociale, një psikolog, tre shefa të njësive, udhëheqës të shërbimeve sociale profesionale, tre udhëheqës të skemës së ndihmës sociale, katër zyrtarë në administratë dhe arkivi. Stafi i QPS-së në përgjithësi ka përvojë administrative nga pesë deri në dhjetë vjet dhe ekspertizë në ofrimin e shërbimeve sociale. Sidoqoftë, për shkak se shumë njerëz janë të mbingarkuar me detyra të shumëfishta, nevojitet planifikim i mëtejshëm i burimeve njerëzore dhe staf shtesë. Përpos nevojës për ngritjen e numrit të punëtorëve socialë, qoftë duke rritur numrin në QPS, qoftë duke punësuar punëtorë socialë përmes formës së kontraktimit të shërbimeve është mëse e nevojshme që punëtorët socialë të trajnohen dhe të profilizohen për shërbime më të mira sociale.

Bashkëpunimi

Në punën e tyre të përditshme, punëtorët socialë dhe Qendrat për punë sociale bashkëpunojnë përpos me palët e tyre, edhe me shumë akterë tjerë të përfshirë në çështjet e palëve të ndërlidhura me QPS, siç janë edhe OJQ-të, organizatat e ndryshme, si dhe bashkëpunojnë ngushtë me Policinë e Kosovës, prokurorinë dhe gjykatën.

Vizioni i planit të veprimit për shërbime sociale

Vizioni ynë është ndërtimi i një sistemi të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse, të barabarta, të arritshme dhe të qëndrueshme, që reflekton nevojat reale të qytetarëve dhe komuniteteve në Komunën e Prishtinës. Ky sistem do të ofrojë shërbime të ndjeshme ndaj individit, të bazuara në të drejtat e njeriut, solidaritet dhe dinjitet, nëpërmjet një qasjeje bashkëpunuese ndërmjet institucioneve publike, sektorit joqeveritar dhe vetë përfituesve të shërbimeve sociale.

Objektivat strategjikë

- Bashkëpunim i ngushtë me komunitetin lokal;
- Fokus në parandalim dhe ndërhyrje të hershme;
- Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve;

- Ofrim i shërbimeve sa më afër qytetarëve, përfshirë edhe në shtëpi;
- Zhvillim i kapaciteteve profesionale të punëtorëve socialë;
- Krijimi i një sistemi të integruar dhe të monitoruar mirë.

Vlerat themelore

Vlera	Përshkrimi
Respekti	Shërbimet mbështeten në dinjitetin dhe vlerën e çdo individi.
Partneriteti	Bashkëpunim i ndërsjellë me akterët institucionalë dhe komunitetin.
Llogaridhënia	Transparencë, përgjegjësi dhe etikë në ofrim dhe mbikëqyrje.
Drejtësia sociale	Qasje e barabartë për të gjithë, pa diskriminim.
Ambicie sociale	Përkushtim për përmirësim të vazhdueshëm dhe rezultate të larta.

Shtyllat tematike të ndërhyrjes

1. Parandalimi,
2. Përkrahja,
3. Intervenimi i hershëm,
4. Mbrojtje,
5. Përkujdesje,
6. Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli.

Misioni i planit të veprimit për shërbime sociale

Misioni i këtij Plani të veprimit është të ndërtojë dhe forcojë një sistem të shërbimeve sociale dhe familjare që është i drejtë, gjithëpërfshirës dhe njerëzor, i cili i respekton dhe fuqizon qytetarët më të cenueshëm të shoqërisë, përfshirë fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë dhe komunitetet në rrezik, pa asnjëlloj diskriminimi gjinor, etnik apo socio-ekonomik.

Ky mision synon të garantojë qasje të barabartë dhe në kohë në shërbime sociale, aty ku nevojiten më shumë, duke vënë në qendër dinjitetin njerëzor, parandalimin e marginalizimit dhe promovimin e të drejtave themelore për çdo individ.

Përmes këtij Plani, synohet:

- Bashkërendimi efektiv i veprimeve ndërmjet Qendrës për Punë Sociale (QPS), institucioneve komunale dhe partnerëve të shoqërisë civile;
- Zbutja e varfërisë dhe përjashtimit social;
- Promovimi i drejtësisë sociale, barazisë dhe të drejtave të njeriut;
- Parandalimi dhe trajtimi i dukurive sociale si: dhuna në familje, braktisja e shkollës, delikuenca e të rinjve, keqtrajtimi i fëmijëve dhe neglizhenca ndaj të moshuarve;
- Fuqizimi i punonjësve socialë dhe ofruesve të shërbimeve për të ofruar ndërhyrje profesionale, humane dhe të bazuara në nevoja reale.

Për ta realizuar këtë mision, Komuna e Prishtinës angazhohet të:

- Ndërtojë kapacitete institucionale të qëndrueshme;
- Sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
- Konsolidojë partneritetin ndërmjet sektorit publik, OJQ-ve dhe komunitetit;
- Zbatojë mekanizma të qartë për monitorim, vlerësim dhe llogaridhënie në shërbimet sociale.

Ky plan është një thirrje për veprim, bashkëpunim dhe transformim të qëndrueshëm, që synon të kthejë sistemin e mbrojtjes sociale në një shtyllë thelbësore të mirëqenies komunitare dhe dinjitetit njerëzor në Prishtinë.

Objektivat Strategjike të Planit të Veprimit për Shërbime Sociale

Në përgjigje të sfidave aktuale sociale, administrative dhe institucionale me të cilat përballen shërbimet sociale në Komunën e Prishtinës, janë përcaktuar katër objektiva kryesore strategjike, të shoqëruara me nënobjektiva konkrete, që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për të gjitha grupet e cenueshme.

Objektivi 1: Ofrimi i shërbimeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse për grupet e cenueshme

Ky objektivi synon zhvillimin e një qasjeje ndërsektoriale për ofrimin e shërbimeve që përfshijnë bashkërendim midis arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, për një përgjigje të koordinuar dhe të efektshme.

Commented [RK1]: Te lutem objektivat kryesore te vendosen ne plan- materix para objektivave specifike

Nënobjektiva:

- 1.1 Shërbime të integruara për fëmijët në situatë rreziku dhe për familjet e tyre;
- 1.2 Zhvillimi i shërbimeve të përshtatura për të moshuarit në komunitet;
- 1.3 Ofrimi i masave parandaluese për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit në rrezik social.

1. Zhvillimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese;
2. Shërbime të integruara cilësore për qytetarët në nevojë sociale;
3. Shërbime të integruara për të moshuarit.

Objektivi 2: Mbështetje gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara dhe forma alternative të përkujdesjes.

Ky objektivi ka për qëllim fuqizimin e shërbimeve të posaçme për personat me aftësi të kufizuara, duke promovuar përfshirjen e tyre në shoqëri dhe mbështetjen e formave të mbrojtjes alternative për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Nënobjektiva:

- 2.1 Zhvillimi i shërbimeve për të rritur me aftësi të kufizuara;
- 2.2 Ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 2.3 Rritja e mirëqenies sociale për të gjitha grupet në nevojë, përmes qasjeve gjithëpërfshirëse;
- 2.4 Nxitja dhe përkrahja e modeleve të strehimit familjar si alternativë ndaj institucionalizimit.
4. Shërbime të integruara për personat me aftësi të kufizuara.
5. Zhvillimi i banimit social.

Commented [RK2]: Keto objektiva të hijezuara janë sipas planit në matrix

Objektivi 3: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe modernizimi teknologjik i shërbimeve.

Ky objektivi ka për qëllim të avancojë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve sociale përmes investimit në burimet njerëzore dhe infrastrukturë teknologjike.

Nënobjektiva:

- 3.1 Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale, materiale dhe infrastrukturore të QPS-ve;
- 3.2 Krijimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave digjitale për përfituesit dhe rastet;
- 3.3 Themelimi i një njësie për telekëshillim dhe këshillim online, për të përmirësuar qasjen në shërbime në distancë.
7. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, materiale e infrastrukturore
8. Digjitalizimi i bazës të të dhënave

Commented [RK3]: Keto objektiva janë në plan- matrix

Objektivi 4: Sigurimi i strehimit të mbrojtur për grupet në nevojë

Objektivi synon të garantojë qasje të barabartë në strehim të sigurt dhe të përshtatshëm për grupet më të cënueshme të shoqërisë, në përputhje me standardet për mbrojtje dhe dinjitet njerëzor.

Nënobjektiva:

- 4.1 Ofrimi i strehimit emergjent dhe afatshkurtër për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës në familje;
- 4.2 Strehimi i përkohshëm për fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- 4.3 Krijimi i shtëpive me bazë në komunitet për të moshuarit (strehim afatgjatë);
- 4.4 Zhvillimi i strehimoreve të dedikuara për komunitetin LGBTIQ+;
- 4.5 Sigurimi i qëndrueshmërisë për strehimoren e viktimave të trafikimit;
- 4.6 Mbështetja për strehimin e përkohshëm dhe të përshtatur për fëmijët pa përkujdesje familjare.

Commented [RK4]: Kjo objektive nuk eshte e paraqitur ne plan!

Shërbime më cilësore sociale

Shërbimet sociale janë themeli i një shoqërie të drejtë dhe të përfshirë. Ato përfaqësojnë një ndërhyrje të strukturuar për të mbështetur individët, familjet dhe komunitetet në përballje me sfida të ndryshme sociale, ekonomike dhe psikologjike. Përmes këtyre shërbimeve synohet jo vetëm zbutja e varfërisë dhe marginalizimit, por edhe promovimi i barazisë, dinjitetit dhe pjesëmarrjes aktive në jetë publike.

Këto shërbime i drejtohen një game të gjerë përfituesish:

- fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- të miturve në rrezik;
- grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës në familje;
- të rinjve dhe të rriturve me varësi nga substancat;
- personave me sëmundje kronike;
- të moshuarve pa përkujdesje familjare;
- fëmijëve pa kujdes prindëror;
- personave në konflikt me ligjin;
- viktimave të trafikimit dhe abuzimeve seksuale, dhe
- kategorive tjera në rrezik social.

Roli i punonjësve socialë

Punonjësit socialë janë në pararojë të mbrojtjes sociale, duke mbështetur çdo ditë individët më të cënueshëm të shoqërisë. Ata nuk janë vetëm zbatues të shërbimeve, por janë edhe mbrojtës të të drejtave të njeriut, ndërmjetësues të paqes sociale dhe faktorë kyç për fuqizimin e individëve në komunitet.

Me profesionalizëm dhe ndjeshmëri, ata përballen me situata komplekse që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, vendimmarrje të ndërlikuara dhe balancim të interesit të individit me atë të

sigurisë publike. Ata mbrojnë fëmijët nga abuzimi, përkrahin familjet në krizë, ndihmojnë të moshuarit që jetojnë të vetmuar dhe fuqizojnë gratë që dalin nga dhuna.

Sfidat aktuale në ofrimin e shërbimeve sociale

Pavarësisht rolit të tyre kritik, shërbimet sociale në Kosovë – dhe posaçërisht në nivelin komunal, përballen me sfida të mëdha strukturore.

Këto sfida përfshijnë:

- Decentralizim i paqartë dhe i pakonsoliduar, që ka shkaktuar ngatërresa në ndarjen e përgjegjësiave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal;
- Mungesë e burimeve të qëndrueshme financiare, që e pengon ofrimin e shërbimeve bazë për grupet më në nevojë;
- Mungesë e punonjësve socialë të kualifikuar, shpesh me ngarkesë të madhe pune dhe pa përkrahje profesionale të mjaftueshme;
- Vëmendje e pamjaftueshme institucionale, ku puna sociale nuk shihet si përparësi politike dhe nuk promovohet në mënyrë të qëndrueshme;
- Mungesa e strehimeve të sigurt dhe mbrojtëse për viktimat e dhunës, trafikimit apo fëmijët në situata emergjente.

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të garantuar mbrojtje efektive dhe të barabartë për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që jetojnë në margjinat sociale dhe ekonomike të shoqërisë.

Çfarë kërkohet për përmirësim

- Rritje e përkushtimit institucional dhe politik për investime në mirëqenie sociale;
- Zhvillim i një kadri të qartë funksional ndërmjet nivelit lokal dhe qendror;
- Rritje e kapaciteteve profesionale dhe kushteve të punës për punonjësit socialë;
- Zgjerim i infrastrukturës për strehim dhe kujdes të specializuar për grupet më të rrezikuara;
- Forcim i partneritetit ndërmjet institucioneve, OJQ-ve dhe komunitetit për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Për buxhetim efektiv dhe infrastrukturë të përshtatshme për shërbime sociale dinjitoze, përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale janë transferuar në nivelin komunal, mbështetja financiare për realizimin e këtyre përgjegjësiave ka qenë e pamjaftueshme, duke krijuar një boshllëk të madh ndërmjet nevojave të qytetarëve dhe kapacitetit real të Qendrave për Punë Sociale (QPS) për t'iu përgjigjur këtyre nevojave.

Mungesa e buxhetimit adekuat dhe të qëndrueshëm për QPS-të prek drejtpërdrejt cilësinë, qasjen dhe ndikimin e shërbimeve sociale, veçanërisht për grupet më të cënueshme si fëmijët, gratë në situata të dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit pa përkujdesje. Shërbimet janë të fragmentuara, shpesh të vonuara, dhe jo të mjaftueshme për të adresuar në mënyrë të denjë emergjencat sociale me të cilat përballen qytetarët.

Punonjësit socialë në QPS-të përballen çdo ditë me sfida të rënda operacionale:

- Detyrohen të mbulojnë shpenzime nga xhepi i tyre, si për ushqim apo produkte higjienike për përfituesit në raste emergjente;
- Marrin pjesë në vizita në terren me vështirësi për transport, pa kompensim për kohën ose rreziqet që bartin;
- Përballen me rrezik për mirëqenien e tyre personale, veçanërisht në raste që përfshijnë dhunë familjare, abuzim me substanca, ose largim të fëmijëve nga familja;
- Nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për zhvillim profesional të vazhdueshëm, licencim apo trajnime të specializuara në fusha kritike si trauma, mbrojtja e fëmijëve dhe ndërhyrjet në krizë.

Për më tepër, mungesa e investimeve në infrastrukturë, si ambiente pune të sigurta dhe të pajisura, sisteme digjitale funksionale, dhe logjistikë për shërbime në terren, e bën edhe më të vështirë realizimin e misionit të mbrojtjes sociale në mënyrë profesionale dhe njerëzore.

Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare

Punonjësit socialë janë shtylla themelore e sistemit të mbrojtjes sociale, duke punuar çdo ditë me individët dhe familjet më të cenueshme në shoqëri. Ata promovojnë të drejtat, barazinë dhe pavarësinë, ndërsa ndërhyjnë në situata të ndërlikuara që prekin mirëqenien e fëmijëve, të rriturve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuara.

Si mbrojtës të drejtpërdrejtë të interesit më të mirë të fëmijës, të mbijetuarve të dhunës, apo viktimave të trafikimit, punonjësit socialë janë në vijën e parë të ndërhyrjes dhe mbrojtjes, shpeshherë në rrethana të rrezikshme, stresuese dhe emocionalisht të ngarkuara. Për këtë arsye, puna e tyre kërkon jo vetëm kompetenca profesionale, por edhe mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme institucionale.

Sfidat që kufizojnë fuqizimin profesional të punonjësve socialë:

- Mungesa e vëmendjes institucionale dhe përkushtimit politik, që reflektohet në mungesën e buxhetit të dedikuar për zhvillim profesional dhe përmirësim të kushteve të punës;
- Numër i pamjaftueshëm i stafit në QPS, që bën që një punonjës social të menaxhojë shumëfishin e rasteve të rekomanduara nga standardet minimale profesionale;
- Nevoja e thellë për staf të specializuar, përfshirë psikologë, sociologë, zyrtarë ligjorë, pedagogë dhe personel mbështetës si shoferë dhe ndihmës teknikë;
- Mungesë e trajnimeve të strukturuar dhe mbikëqyrjes profesionale, që pengon zhvillimin cilësor të praktikës sociale dhe rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve komplekse.

Qasja e rekomanduar për zhvillim të qëndrueshëm të kapaciteteve:

Për të adresuar këto sfida, është përcaktuar një objektivi specifik brenda Planit të veprimit që synon:

- Ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në QPS dhe strukturat tjera ofruese të shërbimeve;
- Rekrutimin e stafit të ri me profile profesionale të nevojshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të shërbimeve sociale;

- Ofrimin e trajnimeve të detyrueshme dhe të vazhdueshme për të gjitha kategoritë e stafit, me fokus në ndërhyrje të bazuar në prova, qasje të ndjeshme gjinore dhe të drejtat e njeriut;
- Krijimin e njësive për mbikëqyrje dhe këshillim profesional, për të siguruar që puna sociale të jetë jo vetëm teknike, por edhe e reflektuar dhe etike;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet komunës, shoqërisë civile, universiteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të ndërtuar një ekosistem të qëndrueshëm zhvillimi profesional për punonjësit socialë.

Treguesit për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e progresit në ngritjen e kapaciteteve profesionale janë të përfshirë në Kornizën e Treguesve të Performancës, në fund të këtij dokumenti, dhe do të përdoren për të siguruar transparencë, përgjegjësi dhe progres të matshëm në ndërtimin e një shërbimi social dinjitoz dhe të besueshëm për qytetarët e Komunës së Prishtinës.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Shërbime Sociale

Për të qenë efektiv dhe me ndikim të qëndrueshëm, procesi i planifikimit dhe zbatimit të shërbimeve sociale kërkon një sistem të mirëfilltë të monitorimit dhe vlerësimit. Monitorimi nuk është thjesht një aktivitet teknik – ai është një mjet kyç për llogaridhënie sociale, transparencë institucionale dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Në kuptimin më të gjerë, monitorimi përfshin mbledhjen sistematike dhe të rregullt të të dhënave, analizimin e rezultateve dhe përdorimin e tyre për të ndjekur progresin kundrejt objektivave të planit të veprimit, për të identifikuar ngecjet, për të zbuluar modelet e performancës dhe për të siguruar që veprimet të përputhen me standardet ligjore, profesionale dhe etike.

Sfidat dhe nevoja për një sistem të sofistikuar të monitorimit social

Aktualisht, një nga sfidat kryesore në ofrimin e politikave sociale cilësore është mungesa e një sistemi funksional, gjithëpërfshirës dhe të informatizuar të monitorimit dhe vlerësimit. Mungesa e të dhënave të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të analizueshme e bën të vështirë përcaktimin e ndikimit real të masave sociale.

Pa monitorim të strukturuar dhe të përdorshëm, vështirësohet:

- të matet ndikimi i ndërhyrjeve sociale në jetën e qytetarëve;
- të përcaktohet nëse burimet janë përdorur në mënyrë të drejtë dhe efektive;
- të evidentohet cilësia e ulët e shërbimeve dhe të ndërmerren masa për përmirësim;
- të sigurohet angazhim më i mirë i stafit për të reflektuar mbi punën e tyre dhe për të mësuar nga praktikatat.

Masa konkrete për ngritjen e një sistemi efektiv të monitorimit

Për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm, të thjeshtë për përdoruesit dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e performancës sociale, do të ndërmerren këta hapa:

- Themelimi i Grupit të monitorimit për zbatimin e Planit të veprimit, me përfaqësim ndërsektorial dhe ndërinstitucional;
- Organizimi i takimeve të rregullta tremujore të grupit monitorues për të shqyrtuar progresin dhe adresuar çështjet prioritare;
- Përpilimi i raporteve të monitorimit, me fokus në:
 - rezultate konkrete dhe të matshme,
 - vlerësimin e zbatueshmërisë së masave,
 - evidentimin e sfidave dhe vonesave,
 - propozime për rregulla dhe hapat e ardhshëm;
- Zhvillimi i një platforme të digjitalizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, që do të mundësojë krahasime ndër vite dhe monitorim të vazhdueshëm në kohë reale;
- Përfshirja e zërit të qytetarëve dhe përfituesve në procesin e vlerësimit të shërbimeve, përmes mekanizmave të ankesave, sondazheve dhe konsultimeve publike.

Kultura e përmirësimit të vazhdueshëm

Përmirësimi i vazhdueshëm duhet të jetë filozofi e përbashkët në të gjitha nivelet e ofrimit të shërbimeve sociale. Çdo institucion, çdo profesionist dhe çdo strukturë duhet të jetë në gjendje:

- të raportojë për rezultatet e arritura,
- të mësojë nga dështimet dhe sukseset,
- dhe të angazhohet për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Vetëm përmes monitorimit të mirëstrukturuar, të sinqertë dhe të qëndrueshëm, shërbimet sociale mund të avancojnë në përmbushjen e misionit të tyre për të ndihmuar, mbrojtur dhe fuqizuar qytetarët në nevojë.

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit të veprimit, është ngritur një grup punues gjithëpërfshirës, i përbërë nga përfaqësues të nivelit komunal dhe të shoqërisë civile. Pjesëmarrja e tyre siguron një qasje të balancuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse në planifikimin dhe zbatimin e politikave që adresojnë nevojat e komunitetit. Anëtarët e këtij grupi janë përzgjedhur duke u bazuar në ekspertizën e tyre, rolin institucional dhe angazhimin në çështje me rëndësi publike, me qëllim të garantimit të një procesi bashkëpunues dhe efektiv. Më poshtë paraqiten emrat e pjesëmarrësve në këtë grup punues.

Grupi punues nga Komuna e Prishtinës:

1. Adelinë Sahiti - Drejtorja e Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës;
2. Fetije Azemi - Drejtorja e Financave, Komuna e Prishtinës
3. Premtim Fazliu - DMS, Komuna e Prishtinës;
4. Besarta Morina – DMS, Komuna e Prishtinës;
5. Fatmir Bilalli - Drejtorja e Emergjencave, Komuna e Prishtinës;
6. Bajram Shala - Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës;
7. Naim Gashi - Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës;
8. Naime Azemi - Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës

Grupi punues mbështetës:

1. Donjeta Kelmendi – KOMF;
2. Baki Gimolli - Institucioni i Avokatit të Popullit;
3. Remzije Krasniqi - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë;
4. Mjellma Luma - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë;
5. Ariana Shala - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë;
6. Nita Luzha - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë;
7. Arjeta Rexhaj - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë;
8. Ibadete Krasniqi - OFAP;
9. Albana Hoti, OFAP;
10. Teuta Abrashi - Qendra MVPT;
11. Fjolla Hoxha - Terre de Hommes;
12. Dorina Lluka Davis - YMCA Kosovo;
13. Sebahate Hajdini Beqiri - Sindrom Down;
14. Rukije Gashi - Shoqata e të shurdhërve;
15. Afërdita Gashi - HANDIKOS;
16. Gresa Stublla - HANDIKOS;
17. Vebi Mujku - facilitues i procesit.

Matrica e planit të veprimit: si dokument i ndarë.

**MATRICA – PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE
KOMUNA PRISHTINË**

2026-2028

OBJEKTIVA SPECIFIKE 1	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI	INDIKATORI
1. Zhvillimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese	1.1. Themelimi dhe funksionalizimi i këshillimores familjare	DMS	Kabineti i Kryetarit	QPS/Këshillimorja	2026-2027	200 000 Euro	Funksionalizimi i këshillimores familjare
	1.2 Zhvillimi i programeve psiko-sociale bazuar ne nevojat e identifikuar te zbatueshme ne kuadër te këshillimores familjare	DMS	OJQ	Këshillimorja	2027	10 000 Euro	Programe te zbatueshme të trajnuar
	1.3. Harmonizimi dhe grumbullimi i materialeve dhe programeve nga OJQ e ndryshme	DMS	DKA, DMS, DSH, OJQ	DMS DKA;OJQ	2026	1 000 Euro	Programi me module 2
	1.4 Organizimi i sesione informative parandaluese në institucione përkatëse për dukuritë negative	DKA DMS DSH Policia Media	DMS; OJQ; QMF; Shkollat	OJQ; DKA	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 50 sesione-2026 Së paku 50 sesione-2027 Së paku 50 sesione-2028
	1.5. Fushata vetëdijesuse për grupet e cenushme	DMS	DKA;OJQ	DKA;OJQ	2026-2028	2 000 Euro	Së paku 5 fushata për vit
	1.6 Trajnime për prindërim pozitiv	DMS	QPS, OJQ, Shkolla, QMF	Qendra për Këshillim Familjar / OJQ	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 200 përfitues
	1.7. Shërbim mobil informues për komunitetet rurale	DMS	KLSP, QMF, QPS, Komuna, OJQ, polici i lagjes, bashkësitë lokale, bashkësitë fetare, shoqatat,	Ekip mobil i profesionistëve socialë	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 200 përfitues
2. Shërbime të integruara cilësore për qytetarët në nevojë sociale	2.1 Ofrimi i shërbimeve sociale, arsimore, shëndetësore, cilësore në familje në nevojë sociale, nëpërmjet OJQ kontraktuese dhe donatoreve te ndryshëm	DMS	MD, Drejtoritë komunale përkatëse	QPS,OJQ-të	2026-2028	500.000 Euro (2026) dhe donatorët, OJQ-të e kontraktuara	20.000 direkt për vit; 30.000 indirekt për vit
	2.2 Ofrimi i shërbimeve sociale cilësore ditore për fëmijë, dhe të rritur në nevojë sociale	DMS	QPS,OJQ	QPS, OJQ	2026-2028	350.000 Euro	1 000 përfitues për vit

	2.3 Ofrimi i shërbimeve sociale cilësore rezidenciale, për fëmijë dhe të rritur, në nevojë sociale	DMS	QPS, OJQ	QPS,OJQ	2026-2028	350.000 Euro	1 000 përfitues për vit-
	2.4. Themelimi dhe funksionalizimi i shtëpisë me bazë në komunitet	Komuna, MFPT, OJQ	DMS	DMS	2028	250 000 Euro	20 përfitues
	2.5 Themelimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve	Ministria përkatëse; DMS	Komuna	Shtëpia e Fëmijëve dhe institucionet tjera përgjegjëse	2026-2028	152.500 Euro 2026 215 000 Euro 2027 215 000 Euro 2028	50 përfitues
	2.6 Ofrimi i shërbimeve për jetesë të pavarur të fëmijëve pa kujdes prindëror pasi mbushin 18 vjet deri 26 vjet	DMS/QPS	OJQ; Qendrat e karrierës brenda shkollave	QPS; OJQ	2026-2028	20 000 Euro	Së paku 5 përfitues p
	2.7 Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në strehim familjar	DMS/QPS	OJQ	QPS	2026-2028	20 000 Euro	5 për vit, 2026-2028
	2.8 Mbështetja financiare për fëmijët dhe të rinjtë e strehuar në familje strehuese dhe strehim emergjent	DMS	QPS, DKA	QPS, OJQ	2027	30.000 Euro	20 për vit-2026-2028
3. Shërbime të integruara për të moshuarit	3.1 Ofrimi i strehimit, kujdesit dhe shërbimeve për të moshuarit pa kujdes familjar	DMS	Komuna, MD paneli për vendosje	Shtëpia për të moshuar	2026-2028	900.000 Euro2026 1 000 000 Euro 2027 1 000 000 Euro 2028	65 klient për vit
	3.2 Aktivitete rekreative, kulturore dhe mbështetëse për të moshuarit në qëndrim ditor	DMS	QPS, OJQ, DKA	DMS, OJQ	2026-2028	350.000 Euro	500 përfitues për vit-2

3.3 Ofrimi i shërbimeve në shtëpi për të moshuarit përmes njësisë mobile dhe përmes vullnetarëve	DMS	QPS;QMF	OJQ-të	2026-2028	10.000 Euro	2000 përfitues -2026-
3.4 Zhvillimi i mjetit për monitorim e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për të moshuarit në shërbimin rezidencial ashtu edhe në atë ditorë.	DMS	DMS	DMS	2026-2028	5 000 Euro	Së paku 50 monitorim
3.5 Kontroll rutinore nga mjeku familjar (matja e tensionit, diabetit).	DMS/SHMPPF	DMS, DSH, QKMF	QKMF	2026 - 2028	1 000 Euro	Së paku 12 herë gjatë
3.6 Ngritja e kapaciteteve të stafit që ofrojnë shërbime.	DMS	DMS,SHMPKF	DMS, OJQ	2026 - 2028	5 000 Euro	Në përputhje me stand
3.7 Rritja e numrit të të punësuarve të profileve adekuate	Komuna	DMS	DMS	2026 - 2028	20 000 Euro	Në përputhje me stand
3.8 Kartela sociale për pensionistet e cila mundëson a) organizim te vizitave turistike brenda vendit pa pagese	DMS	DMS, Shoqata	DMS	2026 - 2028	5 000 Euro	Secili përfitues do të p sociale
3.9 Qendra te reja ditore për aktivitete rekreative dhe sociale ne lagje	DMS	DMS, OJQ	OJQ	2026 - 2028	100 000 Euro	Hapja e 2 qendrave di
3.10 Dizjanimi dhe zhvillimi i Programi “Jetojmë me dinjitet” – asistence shtëpiake për të moshuarit që jetojnë vetëm.	DMS	OJQ, Partneret	Partnerët	2026	100 000 Euro	Programi i dizjanuar Së paku 1 000 përfitu

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera				
OBJETKIVA SPECIFIKE II	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI
4.Shërbime të integruara për personat me aftësi të kufizuara	4.1 Furnizimi me pajisje ndihmëse dhe materiale didaktike dhe vizuale për personat me aftësi të kufizuara	DMS	Donatorët; OJQ	DMS	2026-2028	500.000 Euro
	4.2 Përmirësimi dhe sigurimi i qasjes dhe infrastrukturës për persona me aftësi të kufizuara në objektet publike dhe hapësira publike	Komuna	Drejtoritë përkatëse	Drejtoritë përkatëse	2026-2028	20 000 Euro
	4.3 Ekipi mobil për ofrim të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	DMS	OJQ	OJQ	2026-2028	30.000 Euro
	4.4 Themelimi i qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara.	DMS	OJQ	OJQ	2026-2028	100 000 Euro
	4.5. Pajisja e gjitha institucioneve komunale me mjete dhe material në gjuhën e shenjave	Komuna		OE	2026- 2028	20 000 Euro
	4.6 Sigurimi i pajisjeve dhe qasjes në shërbime përmes mjeteve asistive për PAK	Komuna	DMS, Drejtoria e Administratës	OE	2026 – 2028	20 000 Euro
5.Zhvillimi i banimit social	5.1 Hartimi i planit 3 vjeçar të banimit social	Kabineti i Kryetarit	Drejtoria e Pronës	DMS, Drejtoritë përkatëse	2026-2028	10 000 Euro

5.2 Ofrimi i ndihmës për mbulimin e kostos së qirasë	DMS	DMS	DMS	2026-2028	120.000 Euro
5.3. Mbështetja në banim për personat që dalin nga kujdesi alternativ, dhe në nevojë për jetesë të pavarur të mbikëqyrur 18 deri 26 vjeç	DMS	DMS, QPS, OJQ	QPS	2026 – 2028	20 000 Euro
5.4 Mbështetja financiare për viktime të dhunës në familje për banim	DMS	DMS	DMS	2026-2028	150.000 Euro

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera				
OBJETKIVA SPECIFIKE III	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI
6. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, materiale e infrastrukurore	7.1 Rritja e numrit të stafit profesional (punëtorë social, psikolog) në QPS	Komuna e Prishtinës; QPS; Sektori i Burimeve Njerëzore	MD MFPT MAPL	DMS	2026-2028	320 000 Euro
	7.2 Ngritja e kapaciteteve profesionale	DMS, DKA	QPS	OJQ dhe institucionet e akredituara dhe licencuara; Këshilli i	2026-2028	50.000 Euro

<p>përmes pjesëmarrjes aktive në trajnime të stafit të komunës dhe OJQ-ve</p> <p>7.3. Trajnimi i stafit të DKA-se, QPS-së, DMS-së i modulit të integruar për shërbime sociale</p> <p>7.4. Ndjekja e trajnimeve, retreat, vizita studimore, vlerësim i nevojave për stafin e SHPMPF-se</p> <p>7.4.1 Super vizion, në parandalimin e djegies profesionale</p>			Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare; IKAP		
7.5 Rigjenerimi i hapësirave të SHPMPF-së dhe Qëndrimeve ditore për të moshuarit	DMS	Komuna e Prishtinës; Donatorët e huaj;	Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrat dhe drejtoritë dhe njësitë e tjera komunale; Kompanitë e kontraktuara;	2026-2028	100.000 Euro
7.6 Financimi për shtëpinë me bazë në komunitet	DMS	Drejtoria për Investime kapitale dhe të tjera	DMS	2026-2028	630.000 Euro
7.7 Renovime të qendrave të ndryshme sociale (Qëndrimet ditore për të moshuar, QPS, etj).	DMS	DMS	NPB	2026 - 2027	200 000 Euro
7.8 Financimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve në situatë emergjente	DMS	MFPT, Drejtoria e urbanizmit, drejtoria e planifikimit, drejtoria e investimeve kapitale, sektori i prokurimit publik, DMS		2026-2028	735 000 Euro
7.9 Inventarizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve	DMS			2028	100 000 Euro
7.10 Sigurimi i fondit për raste emergjente që trajtohen nga QPS (veshmbathje, ushqim, etj.);	DMS	QPS	QPS	2026-2028	30.000 Euro

7.Digjitalizimi i bazës së të dhënave	8.1. Krijimi teknik i data bazës dhe mirëmbajtjes	DMS	DA	OE	2026-2028	200.000 Euro
	8.2 Mbledhja e të dhënave aktuale, strukturimi, unifikimi dhe integrimi i të dhënave dhe qasje integrale data bazat e organizatave që ofrojnë shërbime direkte	QPS	Shtëpia e të moshuarve; shtëpia e fëmijëve	QPS	2026-2028	10 000 Euro
	8.3 Trajnim i stafit për përdorim të bazës të dhënave;	DMS	QPS; Shtëpia e të moshuarve; shtëpia e fëmijëve	OE	2026 – 2028	10 000 Euro

Narrativa e Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Komunën e Prishtinës 2026–2028

Plani i Veprimit për Shërbimet Sociale dhe Familjare për periudhën 2026–2028 në Komunën e Prishtinës paraqet një përgjigje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj nevojave në rritje për mbrojtje sociale, përkrahje familjare dhe integrim social të grupeve të cenueshme. Ky plan është hartuar në përputhje me prioritetet e zhvillimit social të komunës, standardet nacionale dhe ndërkombëtare të shërbimeve sociale, si dhe me qasjen e decentralizimit të shërbimeve.

Në qendër të Planit qëndron krijimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, të cilat synojnë jo vetëm trajtimin e rasteve ekzistuese, por edhe parandalimin e problemeve sociale dhe promovimin e mirëqenies në komunitet. Plani është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

1. Parandalimi dhe Promovimi i Mirëqenies Familjare

Në kuadër të këtij objekti, synohet ngritja e qendrës këshilluese për familje dhe zhvillimi i programeve psiko-sociale të orientuara drejt grupeve në rrezik. Aktivitetet përfshijnë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i këshillimores familjare.
- Zhvillimi i programeve të bazuara në nevojat psiko-sociale të komunitetit.
- Organizimi i sesioneve informuese dhe fushatave vetëdijësuese kundër dukurive sociale negative.
- Trajnime për prindërim pozitiv dhe krijimi i shërbimeve mobile për informim në zonat rurale.

Qëllimi është të promovohet një qasje proaktive dhe edukative në adresimin e çështjeve sociale, duke e vënë theksin tek mbështetja për familjen si njësi themelore e komunitetit.

2. Ofrimi i Shërbimeve të Integruara dhe Cilësore për Grupet në Nevojë

Kjo shtyllë fokusohet në forcimin e sistemit të shërbimeve për fëmijë, të rritur, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara dhe viktime të dhunës. Aktivitetet përfshijnë:

- Shërbime ditore, rezidenciale dhe shtëpiake për fëmijët dhe të rriturit në nevojë.
- Themelimi i shtëpive mbrojtëse dhe qendrave ditore për grupet e marginalizuara.
- Mbështetje për jetesë të pavarur për të rinjtë pas përfundimit të kujdesit institucional.
- Shërbime për të moshuarit, përfshirë strehim, aktivitete ditore dhe kujdes mjekësor në shtëpi.
- Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara përmes pajisjeve ndihmëse, qasjes në infrastrukturë dhe ofrimit të përkujdesjes nga ekipet mobile.

Ky dimension përfaqëson angazhimin e komunës për t'u siguruar që askush të mos mbetet prapa, dhe që çdo individ të ketë qasje të barabartë në shërbime humane dhe të personalizuar.

3. Ngritja e Kapaciteteve Njerëzore, Infrastrukturore dhe Digjitale

Ky komponent i Planit ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve për të ofruar shërbime të standardizuara dhe të qëndrueshme. Aktivitetet përfshijnë:

- Zgjerimi i stafit profesional (psikologë, punëtorë socialë) në Qendrat për Punë Sociale.
- Trajnime të specializuara për stafin komunal dhe të OJQ-ve.
- Investime në infrastrukturën e objekteve sociale si rigjenerimi i qendrave ekzistuese dhe ndërtimi i qendrave të reja.
- Digjitalizimi i të dhënave dhe krijimi i një baze të integruar për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve.

Përmes kësaj shtylle synohet rritja e profesionalizimit dhe efikasitetit të shërbimeve, për të ofruar ndihmë në kohë dhe të mbështetur në evidenca.

Përfundim

Ky Plan Veprimi i strukturon ndërhyrjet në mënyrë strategjike për të siguruar një sistem të fuqishëm dhe reagues të shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës. Ai mbështetet në

parime të barazisë, gjithë përfshirjes, respektit për dinjitetin njerëzor dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Përmes bashkëpunimit ndërinstytucional, përfshirjes së sektorit joqeveritar dhe aktivizimit të komunitetit, ky plan synon ta shndërrojë Prishtinën në një komunë me politika sociale të avancuara dhe të ndjeshme ndaj nevojave të qytetarëve të saj.

Verifikimi i rekomandimeve për zhvillimin e Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës 2026-2028, bazuar në hartëzimin social

Rekomandimet për zhvillimin e Shërbimeve Sociale në Komunën e Prishtinës

Rekomandimet për zhvillimin e shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës janë rezultat i Hartëzimit Social LNOB (“Pa lënë askënd pas”) dhe i hartimit të politikave të bazuara në evidenca, të realizuara nga nëntori 2023 deri në shkurt 2024. Popullata e synuar për këtë studim janë personat e moshuar që jetojnë në Komunën e Prishtinës, me theks të veçantë te gratë.

Në nëntor u mbajt takimi fillestar me Komunën, gjatë të cilit përfaqësuesit komunalë u informuan mbi metodologjinë e hartëzimit social, qëllimet dhe rezultatet e pritura të saj. Gjatë muajit dhjetor u zhvilluan grupe fokusi me palë të ndryshme të interesuara në komunë. Në të njëjtën kohë, pyetësori i hartëzimit social u redaktua dhe u përshtat sipas kontekstit lokal. Trajnimi i intervistuesve u realizua në fund të dhjetorit. Grumbullimi i të dhënave u bë në janar, me pjesëmarrjen e 200 të anketuarve, ndërsa analiza dhe raportimi u kryen në muajin shkurt.

Hartëzimi social përfshiu si zonat urbane ashtu edhe ato rurale të Komunës së Prishtinës. Fillimisht u organizuan dy grupe fokusi me një numër më të gjerë të palëve lokale të interesuara, për mbledhjen e të dhënave shtesë dhe për verifikimin e gjetjeve fillestare të identifikuarra nëpërmjet hulumtimit në tavolinë. Në zonat urbane, vëmendja u përqendrua në katër lagje ku ndodhen qendrat ditore për të moshuarit: Tophane, Ulpiana, Aktash dhe Pejton.

Analiza u udhëhoq nga tregues të lidhur me faktorët e rrezikut, si statusi socio-ekonomik, pozita gjeografike, qeverisja, diskriminimi dhe cenueshmëria ndaj fatkeqësive natyrore. Kjo ka mundësuar një kuptim më të thellë të nevojave konkrete të grave të moshuara dhe të prioriteteve për ndërhyrje të përshtatshme sociale.

Grupet e Cenueshme – Popullsia e Moshuar në Prishtinë

- Të moshuarit që jetojnë vetëm – përballen me rreziqe nga izolimi social, që shpesh çon në probleme shëndetësore fizike dhe mendore.
- Të moshuarit me të ardhura të kufizuara – sidomos ata me më pak se 200 euro në muaj.
- Të moshuarit me probleme shëndetësore – përfshirë ata që kërkojnë pajisje mbështetëse dhe kujdes të specializuar.
- Të moshuarit me lëvizshmëri të kufizuar – që jetojnë në ndërtesa pa ashensorë ose me kushte të papërshtatshme.
- Gratë e moshuara – përballen me sfida shtesë për shkak të mungesës së shërbimeve të dedikuara.

- Të moshuarit pa rrjete mbështetëse sociale – të cenueshëm ndaj vetmisë dhe depresionit.
- Të moshuarit pa qasje në kujdes shëndetësor – pa mundësi për vizita mjekësore apo trajtim në shtëpi.
- Të moshuarit me qasje të kufizuar në shërbime sociale – si qendra ditore, mensa sociale dhe transport.

Grupet më të Cenueshme në Fokus

- Gratë e moshuara që jetojnë vetëm apo përballen me probleme shëndetësore.
- Të moshuarit me lëvizshmëri të kufizuar që jetojnë në banesa të paarritshme.
- Të moshuarit me të ardhura të ulëta, sidomos ata që mbështeten vetëm në pension.
- Individët e moshuar të izoluar nga rrjetet familjare apo shërbimet komunitare.

1. Tabela e Shërbimeve Sociale - Komuna e Prishtinës

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Statusi socio-ekonomik	Të moshuarit	Nuk ka	Programe të Ndihmës Financiare	Krijimi i një Programi Komunal të Subvencionimit për shpenzime bazë si ushqimi dhe energjia	100	Prishtinë	500 €/muaj qira Renovim 5000 € (jo nga komuna) Ushqimi dhe energjia do të mbulohen nga donatorët	Donatorët, Komuna	Komuna	OJQ-të
		Nuk ka	Mundësi Punësimi me orar të Pjesërishëm	Krijimi i një nisme Komunale për punësim në komunitet	Ndërmarrje sociale – 25 gra në rrobaqepësi, 50 gra	Prishtinë	24,200 €	OJQ-të, AKM, NALAS	Komuna	OJQ-të
		Shërbime shtëpiake për të moshuar përmes njësive	Shërbim Shëndetësor i qasshëm dhe me Cilësi	Sigurimi i pajisjeve ndihmëse si lupa dhe aparate presioni për të	6000 kontrolle në QMF/klinika	Prishtinë	NA	Komuna, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies	Komuna	OJQ

		mobile dhe vullnetarëve		moshuarit përmes subvencioneve						
		Aktivite rekrutative, kulturore dhe mbështetëse për të moshuarit në qendrat ditore	Ndërveprim dhe mbështetje sociale	1. Themelimi i qendrave ditore, klubeve sociale, dhe mensave 2. Sigurimi i pajisjeve si makina qepëse, mjete kopshtarje etj.	500/muaj	Prishtinë	200,000 €	Biznes privat, OJQ		OJQ
		Nuk ka	Mirëqenie psikosociale	Ofrimi i këshillimit psikosocial në shtëpi për të moshuarit	20	Prishtinë	5500 €	OJQ, AKM	Komuna	OJQ, AKM

2. Tabela e Shërbimeve Sociale sipas Gjeografisë – Komuna e Prishtinës

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Gjeografia	Të moshuarit	Nuk ka	Transport i qasshëm në zonat rurale	Zhvillimi i shërbimeve të organizuara të transportit për të adresuar	NA	Prishtinë	Në bashkëpunim me drejtorinë	Komuna	Komuna	Komuna

				sfidat e mobilitetit (zgjerimi i linjave urbane – tashmë i realizuar)			tjera të Komunës			
		Pjesërisht	Sigurimi i qasjes në strehim	Ndërtimi i rampave dhe shtigjeve të qasshme për banesat e të moshuarve (aktualisht në proces)	Të gjithë	Prishtinë	1,500,000 €	Investime kapitale	Komuna	OJQ, Komuna, NPB
		1. Strehim, kujdes dhe shërbime për të moshuarit pa përkujdesje familjare 2. Ndihmë njëherësh për mbulimin e qirasë 3. Inventar i banesave me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm	Shërbime Mbështetëse për Strehim të Përbalueshëm	Nisja e një Programi të Ndihmës për Strehim, përfshirë subvencione qiraje dhe përmirësime në qasjen e banesave (Programi tashmë ekziston, por jo specifikisht për të moshuarit; kosto aktuale 175 €/muaj, me	20	Prishtinë	60,000 €	Komuna	Komuna	

				qëllim rritje në 300 €)						
--	--	--	--	-------------------------	--	--	--	--	--	--

3. Tabela e Qeverisjes – Shërbime Sociale për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Qeverisja	Të moshuarit	Diskutime publike – vlerësim i nevojave	Politika të synuara për nevojat e të moshuarve	Krijimi i këshillave lokale këshillëdhënëse për të moshuarit, integrimi i nevojave të tyre në politikat komunale dhe nisja e programeve komunitare për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje	Të konfirmohet nga raporti	Prishtinë	NA	Komuna	Komuna	N/A

4. Tabela për Diskriminimin – Shërbime Sociale për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Diskriminimi	Të moshuarit	Nuk ka	Fushata për rritjen e vetëdijes për të luftuar diskriminimin në bazë moshe	Zbatimi i iniciativave komunale për të edukuar publikun, veçanërisht të rinjtë, mbi vlerën dhe kontributin e të moshuarve	NA	Prishtinë	NA	Komuna	Komuna	N/A

5. Tabela për Cenueshmërinë ndaj Krizave – Shërbime për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Cenueshmëria ndaj krizave	Të moshuarit	1. Strehim, kujdes dhe shërbime për të moshuarit pa përkujdesje familjare 2. Ofrimi i	Përgatitje dhe mbështetje për emergjenca	Zhvillimi i sistemeve gjithëpërfshirëse të gatishmërisë për emergjenca, përfshirë ndihmën financiare,		Prishtinë	Buxheti i Prishtinës 2025	Komuna	Komuna	N/A

		shërbimeve në shtëpi përmes njësisë mobile dhe vullnetarëve		mbështetjen psikologjike dhe shërbimet sociale për të rritur qëndrueshmërinë e të moshuarve gjatë krizave si pandemia apo fatkeqësitë natyrore (përmes Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave)						
--	--	---	--	---	--	--	--	--	--	--

Ligjet, udhëzimet dhe rregulloret kryesore që përbëjnë bazën juridike të sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë përfshijnë, por pa u kufizuar:

- Kodi nr. 06/l-006 i Drejtësisë për të Mitur
- Kodi nr. 06/l-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 02/l-118 për Emrin Personal
- Ligji nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore
- Ligji nr. 03/l-007 për Procedurën Jokontestimore
- Ligji Nr. 03/l-037 për Dokumentet e Udhëtimit
- Ligji nr. 04/l – 092 për Personat e Verbër
- Ligji nr. 04/l-003 për Gjendjen Civile
- Ligji Nr. 04/l-215 për Shtetësinë e Kosovës
- Ligji nr. 04/l-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit
- Ligji Nr. 05/L -025 për Shëndetin Mendor
- Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik
- Ligji nr. 06/l- 026 për Azil
- Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji nr. 08/l-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore
- Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme
- Ligji nr. 08/l-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës
- Rregullore (MPB) nr. 03/2018 për Funksonimin e Qendrës për Azil
- Rregullore (QRK) - nr. 18/2024 për përcaktimin e Procedurave Efektive për Identifikimin, Raportimin dhe Referimin ndaj Shfrytëzimit, Neglizhimit dhe Abuzimit të Fëmijës si dhe për Mbrojtjen e Fëmijës në Situatë Rruge
- Rregullore (QRK) - Nr. 23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit
- Rregullore (QRK) nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve
- Rregullore (QRK) nr. 23/2024 për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Njohjes së Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë
- Rregullore (QRK) Nr.07/2024 për Organizimin dhe Fushëveprimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës
- Rregullore QRK Nr 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës
- Rregullore (QRK) Nr.16/2023 për Funksonimin dhe Punën në Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen DHE Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 02/2019 për Procedurat dhe Standardet e Shqyrtimit dhe Marrjes së Vendimit lidhur me aplikacionin për Mbrojtje Ndërkombëtare
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2015 për Procedurën dhe Kriteret e Përcaktimit të Statusit të Personit pa Shtetësi, Mënyra e Fitimit të Shtetësisë për Personin pa Shtetësi dhe Personin me Status të Refugjatit

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 06/2019 për Procedurën e Humbjes së Shtetësisë së Kosovës me Lirim dhe Privim
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.01/2022 për Dokumentet e Gjendjes Civile
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.06/2018 për Procedurat e Pajisjes me Pasaportë
- Udhëzim Administrativ (QRK) - Nr. 02/ 2024 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së fëmijëve në Kosovë
- Udhëzim Administrativ (QRK) - Nr. 04/2023 për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik, të Fëmijës Viktimë e Abuzimit, për t'i Ndhimuar në Rehabilitim dhe për t'u Ri integruar në Shoqëri
- Udhëzim Administrativ (QRK) -Nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 04/2022 për Masat për Mbrojtjen e Fëmijës Kundër Faqeve të Internetit me Përmbajtje Pornografike dhe të atyre që Dëmtojnë Shëndetin dhe Jetën e Fëmijës
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 06/2023 për Masat e Duhura Parandaluese dhe Mbrojtëse për Ndalimin e Pjesëmarrjes së Fëmijëve në Klubet e Natës dhe Hapësira të tjera të Ngjashme
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.05/2024 Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës
- Udhëzim administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr. 05/2023 Masat për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga Abuzimi me Narkotikë
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr. 07/2022 për Autoritetet për të Drejtat e Fëmijës
- Udhëzim Administrativ MD - nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial
- Udhëzim Administrativ MD-nr. 08/2020 për lejimin e pushimit vjetor për të miturit
- Udhëzim Administrativ nr. 01/2014 për Identifikimin e Hershëm të Viktimave të Trafikimit me Njerëz nga Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës
- Udhëzim Administrativ QRK - nr. 10/2017 për listën e treguesve për identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz
- **Memorandumi i Mirëkuptimit** ndërmjet MAPL, MFPT dhe komunave, që përcakton ndarjen e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, dhe të propozimit të grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, miratoi

P L A N I N
VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KRYEQYTETIT

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Kryeqytetit dhe pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Kryeqytetit.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqyteit me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Muaji janar:

- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Të ndryshme.

2. Muaji shkurt:

- Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2026;
- Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

- Propozim-vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026;
- Propozim-vendimi për bartjen e 45 (dyzet e pesë) normave – pozitive nga niveli i arsimit të mësem në nivelin parafillor dhe fillor të mesëm të ulët;
- Propozim-vendimi për subvencionimin e studentëve të programit të bursave “Chevening”, në fushën e inteligjencës artificiale dhe Big Data;
- Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
- Seancë solemne me rastin e përvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- Të ndryshme.

3. Muaji mars:

- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2025 (TM4);
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2025;
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2026;
- Seancë përkujtimore me rastin e përvjetorit të epopesë së UÇK-së;
- Themelimi i Komitetit për Komunitete;
- Të ndryshme.

4. Muaji prill:

- Bartja e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026;
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar – 31 mars 2026 (TM1);
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
- Themelimi i komiteteve të tjera të Kuvendit të Kryeqytetit;
- Raport për efikasitetin energjetik të ndërtesave komunale dhe programin për investime në energji të ripërtëritshme në objektet publike (drejtoria e Shërbimeve Publike).

5. Muaji maj:

- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Informatë mbi gjendjen e rinisë në Kryeqytet;
- Të ndryshme.

6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2026 (nëse ka vendim të qeverisë për rishikimin buxhetor);
- Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028 (KAB);
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike;
- Seancë solemne “11 Qershori - Dita e Çlirimit të Prishtinës”;
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në komunë;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në Kryeqytet (Policia e Kosovës), dhe aktivitetet e KKSB-së (drejtoria për Siguri dhe Emergjencë);
- Informatë për drejtorinë e Sportit në Kryeqytet;
- Diskutim publik lidhur me buxhetin për vitin 2027 në pesë lagjet më të mëdha të Kryeqytetit dhe me dy takime në pjesët rurale;
- Të ndryshme.

7. Muaji korrik:

- Raport i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026;
- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 prill - 30 qershor 2026 (TM2);
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
- Informatë rrethë zbatimit të planit vjetor dhe rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm;
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;

- Informatë për punën e Drejtorisë së Pronës;
- Informatë për performancën e Komunës, MAPL;
- Informatë për realizimin e planit vjetor të Prokurimit Publik, 2026;
- Të ndryshme.

8. Muaji gusht:

Pushim

9. Muaji shtator:

- Propozim buxheti për vitin 2027;
- Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, të Ndërmarrjeve Publike;
- Informatë rreth ofrimit të ndihmave me artikuj të ndryshëm për familjet me gjendje të rëndë sociale, (drejtoria për Mirëqenie Sociale);
- Të ndryshme.

10. Muaji tetor:

- Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2026 (TM3);
- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Raport lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjeve publike;
- Informatë mbi zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF);
- Informatë rreth shtrirjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në Kryeqytet;
- Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë;
- Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027;
- Të ndryshme.

11. Muaji nëntor

- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Miratimi i listës së veçant të pronave për vitin 2027;

- Shqyrtimi i projekt rregullores për tatimin në pronë;
- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Seancë solemne me rastin e festës 28 Nëntori;
- Të ndryshme.

12. Muaji dhjetor

- Raporti i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2026;
- Propozim vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2027;
- Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Të ndryshme.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Kryeqytetit, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

A r s y e t i m

Kuvendi i Kryeqytetit funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL - së, Kuvendi i Kryeqytetit nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Kryeqytetit, në seancën e mbajtur 27.2.2026, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozim planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026.

Grupi punues ka mbajtur takim më 12.3.2026 dhe pas plotësimit ndryshimit të këtij propozim plani, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Kryeqytetit për shqyrtim dhe miratim të tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	16.03.2026
Për/ Za/ To:	z.Fehmi Kupina- Kryesues i Kuvendit.
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	z. Kushtrim Mushica – Drejtor në Drejtorin për Sport.
Tema/ Subjekat/Subject:	Rekomandim



I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës,

Drejtoria për Sport e Komunës së Prishtinës, bazuar në procesin e vlerësimit të kryer nga Komisioni për Subvencione, ju përcjell rekomandimin për përkrahjen financiare të disa klubeve sportive të kryeqytetit.

Komisioni për Subvencione, në mbledhjen e mbajtur më 20.08.2025, ka shqyrtuar kërkesat e klubeve elitare dhe ka rekomanduar që klubet në vijim të subvencionohen përmes Kuvendit të Komunës së Prishtinës:

- **KBF Prishtina** - 25.000€
- **3x3 Prishtina** - 40.000€
- **KH Prishtina** - 30.000€
- **FC Prishtina 01 - Futsal** - 20.000€
- **KV Prishtina 75** - 10.000€
- **KV Prishtina** - 10.000€
- **KB Sigal Prishtina** - 50.000€

Shuma e përgjithshme prej **185,000.00 €**.

Andaj, përmes këtij rekomandimi kërkohet nga Kryesuesi dhe Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të shqyrtojnë këtë rekomandim dhe të miratojnë ndarjen e mjeteve financiare për klubet e lartcekura.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “KLUBIN E BASKETBOLLIT
TË FEMRAVE PRISHTINA”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për “**Klubin e Basketbollit të femrave Prishtina**”, për projektin “**Kërkesë për mbështetje financiare për KBF Prishtina**”.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 25,000.00 € (njëzetë pesë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, në masovizimin e sportit, zhvillimin e vajzave të reja përmes akademisë së klubit, pjesmarrjen aktive në garat zyrtare të FBK-së për grupmoshat e reja dhe afirmimin e basketbollit të femrave në Kosovë dhe rajon.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e “**KBF PRISHTINA**” dhe rekomandimi i komisionit.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KV. PRISHTINA

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **“KV Prishtina”** për projektin **“Kampionati i Kosovës në Volejball-Super Liga A2025/2026”**.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, **Klubit të Volejbollit Prishtina, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për ngritjen e kapaciteteve profesional, zhvillimin e lojtarëve dhe mbarëvajtjen e garave në Superligën A të Kosovës, Kupës së Kosovës, Ligës Gjergj Kastrioti dhe aktivitete për grupmoshat U-14, U-16, U-18 dhe U-21.**

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e **Klubit të Volejbollit Prishtina** dhe rekomandimi nga komisioni.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KLUBIN E BASKETBOLLIT
“SIGAL PRISHTINA”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **“KB Sigal Prishtina”**, për projektin **“Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Basketboll”**, për periudhën 01.09.2025-30.11.2026.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, rikthimin e klubit në **Ligën Evropiane të Basketbollit të Veiut (ENBL)**, promovimin e Prishtinës në arenën ndërkombëtare, ngritjen e turizmit sportiv dhe forcimin e akademisë së basketbollit për zhvillimin e talentëve të rinj.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, nga **“KB SIGAL PRISHTINA”** dhe rekomandimi i komisionit.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026,merr këtë:

V E N D I M

- I.** Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **“Klubin e Futsallit Prishtina 01- Futsal”**, për projektin **“Fc Prishtina 01- Futsal”**, për sezonin sportiv 2025.
- II.** Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është **20,000.00 €** (njëzetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
- III.** Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, Klubit të Futsallit Prishtina 01- Futsal, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për zhvillimin e lojtarëve të rinj dhe promovimin e futsallit në komunitet, duke përfshirë trajnime të rregullta, gara vendore dhe ndërkombëtare, si dhe aktivitete edukativo-sportive për të rinjtë.
- IV.** Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e **“Klubit të Futsallit Prishtina 01 – Futsal”**.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KV. PRISHTINA 75

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për “**K.V. Prishtina 75**” për projektin “**Ngritja e kapacitetit në fushën e Sportit**” për sezonin 2025/2026.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, Klubit të Volejbollit Prishtina 75, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për zhvillimin e lojtarëve të gjitha grupmoshave, ngritjen e kapaciteteve profesionale të klubit, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e sportit të volejbollit dhe promovimin e vlerave sportive tek të rinjtë.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e “**Klubit të Volejbollit Prishtina 75**” dhe rekomandimi nga komisioni.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1 piks **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, ne mbledhjen e mbajtur me .2026, merr këtë

V E N D I M

- I.** Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **“3X3 PRISHTINA”**, për projektin **“3x3 Prishtina Challenger 2025 (edicioni i 4-të)**.
- II.** Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është **40,000.00 €** (dyzetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
- III.** Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, me projektin **”3x3 Prishtina Challenger 2025 (edicioni i 4-të)”**, promovimi global përmes platformave zyrtare të FIBA-s dhe ndikimin direkt në zhvillimin e turizmit sportiv, ekonomisë lokale dhe motivimin e të rinjëve.
- IV.** Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, nga **“3X3 PRISHTINA”** dhe rekomandimi i komisionit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë:

V E N D I M

- I.** Miratohet Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për **“K.H. Prishtina”** për projektin **“K.H. Prishtina drejt titullit kampion dhe garave evropiane”** për sezonin 2025/2026.
- II.** Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është **30,000.00 €** (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
- III.** Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II. Pjesëmarrja e ekipit të parë në Superligën e Kosovës, Kupën e Kosovës dhe garat evropiane, arritjen e titullit kampion dhe zhvillimin e Akademisë së klubit, ku janë të regjistruar mbi 200 të rinj nga grupmoshat fatosë, pionerë, kadetë dhe juniorë.
- IV.** Pjesë e këtij vendimi është kërkesa, projekti dhe dokumentet përcjellëse nga **K.H. Prishtina** dhe rekomandimi i komisionit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e tjera relevante.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë

V E N D I M
PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

1. Miratohet fillimi i procedurave për vënien në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 02.12.2011, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
2. Organizimi i diskutimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, diskutimi publik do të zgjatë 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**DRAFT RREGULLORE
PËR TAKSAT KOMUNALE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE
AFARISTE**

Prishtinë, 2026

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më _____, miratoi këtë:

RREGULLORE
E TAKSAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

QËLLIMI

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale brenda kufijve administrativ të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës (mëtej: Kryeqyteti), lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Kryeqytetit që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. Taksë komunale – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Kryeqytetit në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

1.2. Vit fiskal – nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) dhjetor të të njëjtit vit;

1.3. Person – nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.4. Person fizik – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;

1.5. Person juridik – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

1.6. Taksa për akomodim – është tarifë komunale që paguhet për çdo natë qëndrimi nga personat që shfrytëzojnë shërbime akomodimi.

1.7. Subjekt hotelier – çdo person fizik ose juridik që ofron shërbime akomodimi (hotel, motel, hostel, bujtinë, apartament me qira ditore dhe forma të tjera të akomodimit).

KAPITULLIT II

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale

1. Të gjitha taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohen me këtë Rregullore.

2. Të gjitha taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohen marrë parasysh parimin e mosdiskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Asnjë taksë komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

4. Për ngarkimin dhe inkasimin e taksës për ushtrimin e veprimtarive afariste përgjegjës është Sektori i zhvillimit të qëndrueshëm, i cili njëkohësisht ushtron edhe funksionin e verifikimit dhe kontrollit administrativ lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ndërsa për identifikimin dhe monitorimin e bizneseve në terren përgjegjëse është Drejtoria e Inspektionit, e cila kryen inspektimin e veprimtarive ekonomike, duke përfshirë kontrollin e bizneseve se a janë të pajisura me leje për ushtrim të veprimtarive afariste, sipas kësaj rregulloreje.

Në rastet kur gjatë inspektimeve në terren konstatohen parregullsi ose jepen vërejtje, Drejtoria e Inspektionit njofton Sektorin e zhvillimit të qëndrueshëm për gjendjen faktike në teren.

5. Subjektet afariste do të ngarkohen sipas aktivitetit të ushtrimit të veprimtarisë

6. Përrjashtim nga pika biznesi do të tarifohet/ngarkohen në bazë të raportit të inspektionit i cili konstaton veprimtarin të cilën e ushtron biznesi në teren.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).

2. Të gjitha pagesa bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, në bazë të faturës të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, përmes postes elektronike apo Postës së Kosovës në xhirollogarinë e Komunës.

2. Sektori për zhvillim të qëndrueshëm faturimin do ta realizon më së largu deri në shtator të vitit kalendarik;

3. Subjektet afariste faturën e caktuar do ta paguajnë deri me datën 31 dhjetor të vitit kalendarik për të cilin ngarkohen, në të kundërtën lënda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes inicimit të procedurës përmbarimore;

4. Subjektet afariste faturën e pranuar brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me anë të ankesës drejtuar Komisionit për komunal për ankesa ndaj taksës komunale i caktuar me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.

5. Subjektet afariste të cilat gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive (deklarimet me zero) dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, parashetrojnë ankesë;

6. Shqyrtimin i ankesave kundër faturave të caktimit të taksës për ushtrimin e veprimtarive afariste do ta bëjë komisioni komunal për ankesa ndaj taksës komunale i

caktuar me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.

7. Subjektet afariste ngarkohen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje duke filluar nga muaji qershor i vitit 2026. Përrjashtim bëjnë bizneset që aktualisht tarifohen sipas tarifores ekzistuese; këto do të vazhdojnë të tarifohen sipas sistemit aktual deri në dhjetor 2026, dhe nga 1 janari 2027 do të zbatohen tarifat e reja.

8. Subjektet afariste që selinë e kanë në një komunë tjetër, por ushtrojnë veprimtari në territorin e Kryeqytetit përmes një njësie, do të taksohen me taksë të plotë për atë njësi.

9. Subjektet afariste që në territorin e Kryeqytetit kanë dy (2) ose më shumë njësi, do të taksohen si në vijim:

9.1.Njëra nga njësitë do të faturohet si seli themelore;

9.2.Njësitë e tjera do të faturohen si njësi të saj, sipas kategorizimit përkatës.

10. Njësitë e subjekteve afariste paguajnë 50% nga tarifa bazë.

11. Nëse aktiviteti i njësisë ndryshon nga aktiviteti i selisë themelore, atëherë kjo njësi do të faturohet me taksën e plotë të paraparë me këtë rregullore për atë aktivitet, dhe jo me 50% të tarifës bazë.

Neni 6

Pagesa e taksave, legjitimimi i veprimtarive dhe kompetencat e Kryeqytetit

1. Kryeqyteti nuk ka kompetencë për regjistrimin apo legjitimimin e subjekteve afariste.

2. Kryeqyteti nuk ka kompetencë të përcaktojë mënyrën e organizimit, formën e operimit apo mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve, përveç rasteve kur kjo rregullohet shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

3.Bizneset që ushtrojnë veprimtari në territorin e Kryeqytetit dhe që janë të regjistruara nga institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, obligohen të paguajnë taksën përkatëse komunale në përputhje me këtë rregullore.

4.Pagesa e taksës komunale nuk përbën akt regjistrimi, legjitimimi apo miratimi të mënyrës së operimit të biznesit nga ana e Kryeqytetit, por vetëm përmbushje të detyrimit financiar për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tij.

5.Subjektet afariste që realizojnë pagesën e taksës përkatëse pajisen me Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste, e cila dëshmon vetëm përmbushjen e detyrimit për pagesën e taksës komunale dhe nuk përbën akt regjistrimi apo legjitimimi të biznesit.

Neni 7

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1.Çdo subjekt afarist në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh muajin e regjistrim/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

2.Subjektet afariste të cilat shuhen do të lirohen nga pagesa e taksës për vitin fiskal në të cilin shuhen (lirohen për ata muaj të operimit brenda vitit fiskal).

3. Subjektet afariste të regjistruara në emër të grave dhe vajzave përfitojnë ulje prej 50% mbi tarifën e parashikuar dy vitet e para pas themelimit.

4. Për të përfituar këtë ulje, subjektet afariste janë të obliguara të parashetrojnë kërkesë pranë autoritetit përkatës, pas pranimit të faturës.

Neni 8

Tarifat komunale për veprimtaritë ekonomike

Nr	KATEGORIA	TAKSA
ENERGJIA DHE SHERBIMET PUBLIKE		
3511	Prodhimi i rrymes elektrike	1000.00
3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	1000.00
AUTOMJETE		
4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogel(te reja)	700.00
4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogel(te vjetra)	300.00
KARBURANTE		
4730	Tregtia me pakicë e karburanteve per automjete (zona urbane)	1000.00
4730	Tregtia me pakicë e karburanteve per automjete (zona rurale)	500.00
BARNATORE		
4646	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutike	700.00
4773	Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutike	500.00
HOTELERI		
5510	Hotelet	1000.00
5510	Motelet	500.00
5510	Hostelet	300.00
Sektor Financiar dhe Telekomunikim		
6419	Ndërmjetësime të tjera monetare (bankat)	1000.00
6419	Ndërmjetësime monetare (institucionet mikrofinanciare)	500.00
6110	Veprimtaritë e telekomunikimit (rrjeti fiks dhe mobil)	1000.00
6512	Sigurimi jojetësor	1000.00

SIGURIA		
8010	Aktivitetet e sigurimit privat	300.00
8424	Rendi publik dhe aktivitetet e sigurisë	300.00
8020	Aktivitetet shërbyese të sistemeve të sigurimit	300.00
Ndërtimtari dhe Infrastrukturë		
4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	2000.00
4211	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave	1000.00
4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit	300.00
Automjete dhe Ndërmjetësim		
4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (auto serviset)	700.00
4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (autolarjet)	300.00
4613	Ndërmjetësim për shitjen e drurit dhe materialeve të ndërtimit	1000.00
4615	Ndërmjetësim për mobilie, mallra shtëpiake, pajisje elektronike dhe hekurishteve	500.00
4673	Tregtia me shumice e drurit, materialeve të ndërtimit dhe paisjeve hidrosanitare	700.00
1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdruktarisë tjetër ndërtuese	
3102	Prodhimi i mobileve të kuzhines	
TREGTI ME PAKICE		
4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara (ushqim, pije, duhani) (kategorizim në baze të m ² të lokalit)	300.00--
4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara	300.00
4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit	300.00
4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe argjendarisë	500.00
4778	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja	400.00
4752	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara	500.00
4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiake, në dyqane të specializuara	500.00
Transport dhe Logjistikë		

4939	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve	400.00
5223	Aktivitete shërbyese të rastit për transportin ajror	500.00
5320	Aktivitete të tjera postare dhe të ndërlihdjes	400.00
7911	Aktivitetet e agjencive të udhëtimit,	400.00
7912	Aktivitete të operatorëve turistikë	400.00
Shërbime Profesionale		
6831	Agjenci të patundshmërive	700.00
6910	Aktivitete juridike (Avokatët)	1000.00
6910	Aktivitete juridike (Noterët)	1000.00
6910	Aktivitete juridike (Përmbaruesit privat)	700.00
6910	Aktivitete juridike (Ndërmjetësuesit)	700.00
6920	Kontabilitet, librëmbajtje dhe auditim	500.00
7111	Aktivitete të arkitekturës	500.00
8220	Aktivitete të qendrave të thirrjeve	2000.00
ARSIMI		
8520	Arsimi fillor privat	1000.00
8531	Arsimi i përgjithshëm i mesëm privat	1500.00
8532	Arsimi i mesëm teknik dhe professional privat	1500.00
8542	Arsimi i lartë privat	2000.00
8553	Aktivitete të autoshkollave	300.00
Shëndetësi		
8610	Aktivitete të spitaleve private	3000.00
8622	Aktivitete të mjekësisë së specializuar private	3000.00
8623	Aktivitete të dentistëve	2000.00
8690	Aktivitete të tjera të shëndetit të njeriut	1000.00
Sport dhe Estetikë		
9312	Aktivitete te klubeve sportive	300.00
9313	Palestra fitnesi	500.00
9602	Sallonet e floktarise dhe trajtimet e tjera te bukurise	1000.00
9604	Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore	3000.00

KAPITULLI III

Neni 9

Taksat e akomodimit

1. Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të huajt që qëndrojnë gjatë natës në një strukturë akomoduuese jashtë vendbanimit të tyre paguajnë taksën e akomodimit.
2. Taksa e akomodimit paguhet njëkohësisht me pagesën e akomodimit për një natë.
3. Taksa e akomodimit trajtohet si e hyrë vetanake e komunës dhe i destinohet promovimit dhe zhvillimit të turizmit në komunën përkatëse.
4. Taksa e qëndrimit paguhet në shumën prej **1 (një) euro për person për çdo natë**.
5. Subjektet që ushtrojnë veprimtari akomodimi janë të obliguara të mbledhin dhe paguajnë taksën e akomodimit sipas procedurave të përcaktuara nga komuna.
6. Subjektet obliguese për mbledhjen dhe pagesën e taksës për akomodim janë të gjitha njësitë që ofrojnë shërbim akomodimi brenda territorit të Kryeqytetit.
7. Taksa arkëtohet nga subjekti hotelier në momentin e pagesës së shërbimit të akomodimit.
8. Shuma e taksës paraqitet si pikë e veçantë në faturë.
9. Subjekti hotelier vepron si mbledhës i taksës në emër të Komunës.

Neni 10

Përrjashtimi nga taksa e akomodimit

1. Nga pagesa e taksës së akomodimit përjashtohen kategoritë si në vijim:
2. fëmijët nën moshën shtatë (7) vjeç;
3. personat me referim mjekësor që qëndrojnë në natyrë me qëllim të shërimit;
4. personat e siguruar për të cilët, sipas paraqitjes së fotokopjes së një vendimi të autoritetit kompetent, është e qartë se kanë aftësi të kufizuar ose dëmtim fizik, ose në bazë të një karte të anëtarësimi të një organizate të aftësisë së kufizuar;
5. nxënësit, studentët, udhëheqësit ose mentorët e tyre, pjesëmarrësit në programet edukative të organizuara nga shoqëritë dhe institucionet e tjera arsimore në baza jofitimprurëse ose nga komunitetet fetare dhe të tjera si pjesë e aktiviteteve të tyre të rregullta;
6. nxënësit në konviktet e shkollave dhe konviktet e studentëve;
7. personat të cilët punojnë përkohësisht dhe jetojnë në një objekt të industrisë ushqimore për më shumë se tridhjetë (30) ditë;
8. shtetasit e huaj të cilët janë të liruar nga taksa e akomodimit në përputhje me rregulloret dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
- 1.8. anëtarët e shoqatave të cilët merren me aktivitete sportive, në bazë të një karte të vlefshme të anëtarësimi.

Neni 11

Raportimi në Kryeqytet

1. Subjektet hotelierike janë të obliguara që të raportojnë në Kryeqytet, në baza mujore, të dhënat si vijon:

1.1. numrin total të mysafirëve të akomoduar;

1.2. numrin e netëqëndrimeve;

1.3. shumën totale të taksës së arkëtuar.

2. Raportimi bëhet deri më datën 10 të muajit pasues për muajin paraprak.

2. Raporti dorëzohet në formë elektronike ose fizike në Sektorin e Zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 12

Pagesa e taksës

1. Shuma e taksës së arkëtuar derdhet në llogarinë bankare të Kryeqytetit brenda afatit të raportimit.

1. Pagesa bëhet një herë në muaj, së bashku me dorëzimin e raportit përkatës.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Drejtoria/Spektori kompetent kryen mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Subjektet hotelierike obligohen të sigurojnë qasje në evidencat dhe dokumentacionin përkatës gjatë kontrollit.

KAPITULLI IV

Neni 14

Taksa komunale për hyrje të automjeteve në territorin e Kryeqytetit

1. Me këtë rregullore përcaktohet taksa komunale për hyrjen e automjeteve në territorin administrativ të Kryeqytetit.
2. Çdo automjet i regjistruar jashtë territorit të Kryeqytetit, që hyn në zonën e përcaktuar nga Kryeqyteti, i nënshtrohet pagesës së taksës në shumën prej **10 (dhjetë) euro** për hyrje.
3. Pagesa e taksës realizohet:
 - 3.1. përmes pikave të autorizuara hyrëse;
 - 3.2. përmes sistemit elektronik të pagesës;
 - 3.3. ose përmes platformave të tjera të miratuara nga Kryeqyteti.
4. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse:
 - 4.1. automjetet e shërbimeve emergjente (ambulanca, zjarrfikës, polici);
 - 4.2. automjetet e institucioneve publike në kryerje të detyrës zyrtare;
 - 4.3. banorët rezidentë të Kryeqytetit (me dëshmi të vlefshme);
 - 4.4. kategoritë e tjera të përcaktuara me vendim të veçantë të Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Mos-pagesa e taksës përbën kundërvajtje dhe sanksionohet me gjobë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me Neni 15 të kësaj rregulloreje.
6. Drejtoria kompetente përdhe ajo caktojnë zonat e aplikimit dhe mënyrën e kontrollit të zbatimit të kësaj takse.

KAPITULLI V

Neni 15

Autorizimet e Drejtorisë së Inspektionit

1. Drejtoria e inspektionit është kompetente për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje.
2. Inspektori i Kryeqytetit pas evidentimit se një subject afarist operon pa Leje për ushtrim veprimtarie afariste, njofton subjektin afarist për veprimet të cilat duhet ti ndërmarr për tu pajisur me Lejën për ushtrimin e veprimtarisë afariste brenda afatit kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga momenti i pranimit të procesverbalit nga inspektori.
3. Nëse subjekti afarist nuk e respekton këtë afat për tu pajis me Lejën për ushtrimin e veprimtarisë afariste, Inspektori i Kryeqytetit obligohet të shqiptoj gjobën në vlerën prej 30% të vlerës së taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të cilën është i obliguar ta paguaj sipas kësaj rregulloreje
4. Në rastet kur, subjekti afarist nuk pajiset me Leje për ushtrim të veprimtarisë, të njëjtit obligohet t'i shqiptohet gjoba për herën e dytë në vlerë prej 50% të vlerës së taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të cilën është i obliguar ta paguaj sipas kësaj rregulloreje.
5. Nëse edhe pas shqiptimit të gjobave sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, subjekti afarist nuk paisjet me Leje për ushtrim të veprimtarisë afariste të njëjtit Inspektori i Kryeqytetit obligohet t'i ndalojë kryerjen e veprimtarisë afariste në kohëzgjatje më së shumti prej 8 ditësh.
6. Për të gjitha procedurat e shqiptimit të gjobave, mënyrës dhe afatave të pagesës së

gjobave, si dhe procedurave tjera lidhur me gjobat të cilat nuk janë rregulluar me dispozitat e kësaj rregulloreje, vlejné dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

KAPITULLI VI

Neni 16

Dispozitat shfuqizuese dhe kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e Nenit 2, pika 3 e Rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr.01-110-2782 e dt. 01.12.2011, Vendimi për ndryshimin e Rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 01-110-21449 i dt. 28.02.2013, Vendimi nr. 01-431/04-112314/21 i dt. 16.06.2021 si dhe Vendimi nr. 01-431/04-185458/21 i dt. 03.09.2021 të cilët përfshijnë taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Vendimi për shqyrtimin e ankesave lidhur me ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, 14-020/04-0299221/19 i datës 09.12.2019.
3. Prej momentit të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të aplikohen tarifat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORTI FINANCIAR BUXHETOR I KOMUNËS SË
PRISHTINËS
PËR PERIUDHËN 1 TETOR – 31 DHJETOR 2025 (TM 4)

RAPORTI TREMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
2. Pasqyra e të hyrave për periudhën tetor-dhjetor 2025 dhe krahasimet me vitet paraprake	5
3. Raporti i të hyrave për periudhën tetor-dhjetor 2025, sipas muajve	7
4. Pasqyra e shpenzimeve dhe krahasimet me vitet paraprake	11
5. Pasqyra e shpenzimeve për periudhën tetor-dhjetor 2025.....	12
6. Shpenzimet në projektet kapitale për tremujorin e parë, të dytë dhe të katërt	14
7. Raporti për pasurinë jo financiare	19
8. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPP-së	20
9. Subvencionet për tremujorin e katërt dhe krahasimi me vitet paraprake	21
10. Llogaritë e arkëtuara për vitet 2023, 2024, 2025	21
